



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 210

Tiranë – E Martë, 13 Janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 29.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar..... 12629
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 29.12.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 12632
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014	Për personelin e administratës doganore..... 12632
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 922, datë 29.12.2014	Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike..... 12635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 923, datë 29.12.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 783, datë 10.11.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar..... 12636
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 29.12.2014	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2015, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike Postare..... 12637
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 925, datë 29.12.2014	Për disa shtesa në vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”..... 12637
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes..... 12691
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 29.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të ndryshuar..... 12702

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 931, datë 29.12.2014	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pasurive shtetërore nr. 7/83 dhe nr. 7/82, në zonën kadastrale 8270, për realizimin e projektit “Qendra Kombëtare Kulturore “Skena e Re””.....	12702
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 29.12.2014	Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.....	12705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 934, datë 29.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 909, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës Lin - Pogradec”.....	12708
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 936, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Lefteri Kodra.....	12711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 937, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Bashkim Zaimi.....	12711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 938, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Leka Bungo.....	12711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 939, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Xhevahir Spahiu.....	12711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 940, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Bejkush Birçe.....	12712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 941, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Daut Gumeni.....	12712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 942, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Haxhi Rama.....	12712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Eduard Agostini.....	12712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 944, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Mevlan Shanaj.....	12713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 945, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Aleko Minga.....	12713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 946, datë 29.12.2014	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Mehdi Bushati.....	12713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 947, datë 29.12.2014	Për autorizimin e Albpetrol sh.a., për të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së Albpetrol sh.a., që i takon në bazë të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit.....	12713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 29.12.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 374, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë”.....	12714



AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 29.12.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 185/2013, “PËR
BUXHETIN E VITIT 2014”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 10 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	271 029	milione lekë;
Shpenzimet kapitale	66 004	milione lekë;
Fondi rezervë	1 500	milione lekë;
Kontingenca	1 550	milione lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensione	2 000	milione lekë;
Detyrimet e prapambetura	35 000	milione lekë;
Fond shpronësimesh	1 500	milione lekë;
Huadhënie për energjinë	1 500	milione lekë.”.

b) Tabela 1, e përmendur në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtën numër, bashkëlidhur.

c) Në fund të nenit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Fondi i shpronësimeve prej 1500 milionë lekësh transferohet nga Ministria e Financave në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për shpronësime në proces apo shpronësime të reja.”.

Neni 2

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2014, është 106 701 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

1. Për huamarrjen e brendshme vjetore deri në 50 244 milionë lekë.

2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja deri në 13 167 milionë lekë.

3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 8 290 milionë lekë.

4. Për mbështetjen e huaj buxhetore deri në 35 000 milionë lekë.

Stoku i borxhit shtetëror vlerësohet të arrijë në 931 779 milionë lekë.

Stoku i borxhit të garantuar vlerësohet të arrijë në 59 614 milionë lekë.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

AKTI NORMATIV I VITIT 2014 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shp. kapitale	Totali i shpenzimeve buxhetore
			Nga buxheti	Nga të ardhurat	Financimi i huaj		
1	Presidenca	178,200	5,000	0	0	5,000	183,200
01120	Veprimtaria e Presidentit	178,200	5,000	0	0	5,000	183,200
2	Kuvendi	979,500	48,393	0	0	48,393	1,027,893
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	334,000	48,393	0	0	48,393	382,393
01120	Veprimtaria ligjvënëse	645,500	0	0	0	0	645,500
3	Kryeministria	405,125	60,000	0	0	60,000	465,125
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	405,125	60,000	0	0	60,000	465,125
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	702,350	168,853	0	517,000	685,853	1,388,203
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	217,200	35,875	0	0	35,875	253,075
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	269,900	101,228	0	510,000	611,228	881,128
04160	Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	215,250	31,750	0	7,000	38,750	254,000
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	4,211,261	827,767	0	1,555,105	2,382,872	6,594,133
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	250,200	6,500	0	0	6,500	256,700
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,285,880	105,800	0	386,502	492,302	1,778,182
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	889,670	411,807	0	269,000	680,807	1,570,477
04250	Zhvillimi rural duke mbësht. prodh. bujq. blek, agroind dhe market.	1,480,800	86,060	0	227,278	313,338	1,794,138



04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	212,651	0	0	0	0	212,651
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	20,060	0	0	0	0	20,060
04230	Mbështetje për peshkimin	72,000	217,600	0	672,325	889,925	961,925
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	3,180,755	18,359,364	0	16,168,002	34,527,366	37,708,121
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	270,500	5,000	0	79,000	84,000	354,500
04520	Transporti rrugor	1,824,500	14,617,835	0	6,641,197	21,259,032	23,083,532
04530	Mbështetje për studime në transport	19,730	0	0	0	0	19,730
04540	Transporti detar	73,825	125,000	0	750,000	875,000	948,825
04550	Transporti hekurudhor	458,700	102,234	0	0	102,234	560,934
04560	Transporti ajror	23,000	3,260	0	0	3,260	26,260
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	510,500	3,386,052	0	8,357,805	11,743,857	12,254,357
06220	Menaxhimi i mbetjeje urbane	0	119,983	0	340,000	459,983	459,983
10	Ministria e Financave	5,304,395	496,339	0	205,687	702,026	6,006,421
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	368,920	157,594	0	9,666	167,260	536,180
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	474,535	10,508	0	30,334	40,842	515,377
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	944,830	0	0	0	0	944,830
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	1,972,050	186,437	0	0	186,437	2,158,487
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	1,477,260	139,836	0	165,687	305,523	1,782,783
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	66,800	1,963	0	0	1,963	68,763
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	36,771,450	3,385,351	0	125,000	3,510,351	40,281,801
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	738,000	47,500	0	0	47,500	785,500
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	23,150,000	1,908,378	0	0	1,908,378	25,058,378
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	5,226,450	1,123,869	0	0	1,123,869	6,350,319
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	2,076,000	166,613	0	100,000	266,613	2,342,613
09450	Arsimi universitar	5,256,000	138,991	0	25,000	163,991	5,419,991
09770	Fonde për shkencën	177,000	0	0	0	0	177,000
08140	Zhvillimi i sportit	148,000	0	0	0	0	148,000
12	Ministria e Kulturës	1,242,960	324,335	0	0	324,335	1,567,295
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	133,900	5,000	0	0	5,000	138,900
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	380,420	228,923	0	0	228,923	609,343
08230	Arti dhe kultura	728,640	90,412	0	0	90,412	819,052
13	Ministria e Shëndetësisë	28,629,500	1,880,701	0	375,941	2,256,642	30,886,142
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	226,500	3,500	0	0	3,500	230,000
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	9,003,500	74,445	0	33,720	108,165	9,111,665
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	16,880,500	1,772,756	0	342,221	2,114,977	18,995,477
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,519,000	30,000	0	0	30,000	2,549,000
14	Ministria e Drejtësisë	6,033,470	960,207	0	1,017,000	1,977,207	8,010,677
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	356,700	922,557	0	267,000	1,189,557	1,546,257
01120	Publikimet zyrtare	44,750	100	0	0	100	44,850
01130	Mjekësia ligjore	50,500	11,417	0	0	11,417	61,917
03440	Sistemi i burgjeve	3,935,240	17,272	0	750,000	767,272	4,702,512
03350	Shërbimi i përmbartimit gjyqësor	101,480	7,500	0	0	7,500	108,980
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	11,000	200	0	0	200	11,200
01180	Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave	1,427,600	1,161	0	0	1,161	1,428,761
03490	Shërbimi i provës	106,200	0	0	0	0	106,200
15	Ministria e Punëve të Jashtme	2,243,100	68,000	0	0	68,000	2,311,100
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	96,600	9,000	0	0	9,000	105,600
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,928,500	59,000	0	0	59,000	1,987,500
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	218,000	0	0	0	0	218,000
16	Ministria e Brendshme	15,847,880	1,114,267	0	193,293	1,307,560	17,155,440
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	815,000	24,779	0	0	24,779	839,779
03140	Policia e shtetit	11,691,280	996,006	0	170,000	1,166,006	12,857,286
03150	Garda e Republikës	1,200,800	28,725	0	0	28,725	1,229,525
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	555,200	9,448	0	293	9,741	564,941
01170	Shërbimi i gjendjes civile	700,100	36,183	0	0	36,183	736,283
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	96,700	6,000	0	0	6,000	102,700
10910	Emergjencat civile	788,800	13,126	0	23,000	36,126	824,926
17	Ministria e Mbrojtjes	11,211,300	2,713,124	0	0	2,713,124	13,924,424
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,142,000	2,500	0	0	2,500	1,144,500
02120	Forcat e luftimit	4,478,000	2,628,824	0	0	2,628,824	7,106,824
09430	Arsimi ushtarak	826,000	0	0	0	0	826,000
02150	Mbështetja e luftimit	4,195,700	49,800	0	0	49,800	4,245,500
02280	Bashkëpunimi civilo-ushtarak (AL-CIMIC)	569,600	32,000	0	0	32,000	601,600
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,388,300	45,555	0	0	45,555	1,433,855
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,388,300	45,555	0	0	45,555	1,433,855
19	Drejtorja e Radio-Televizionit	357,000	0	0	0	0	357,000
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	240,000	0	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	0	0	0	0	0	0
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	62,000	0	0	0	0	62,000
08340	Orkestra simfonike RTSH-së dhe kinematografisë	55,000	0	0	0	0	55,000
20	Drejtorja e Përgjithshme Arkivave	170,750	4,567	0	0	4,567	175,317
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	170,750	4,567	0	0	4,567	175,317
22	Akademia e Shkencës	88,000	2,000	0	9,000	11,000	99,000
01520	Veprimtaria akademike	88,000	2,000	0	9,000	11,000	99,000
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	320,150	20,000	0	30,000	50,000	370,150
01120	Veprimtaria Audituese KLSH-së	320,150	20,000	0	30,000	50,000	370,150
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	72,399,810	230,560	4,500	156,350	391,410	72,791,220
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	140,700	13,261	0	0	13,261	153,961
10220	Sigurimi shoqëror	45,421,000	0	0	0	0	45,421,000



10430	Përkujdesja sociale	24,693,500	8,572	0	44,000	52,572	24,746,072
10550	Punësimi, formimi dhe arsimi profesional	1,798,000	24,500	4,500	0	29,000	1,827,000
04170	Inspektimi në punë	163,500	2,000	0	0	2,000	165,500
10460	Përfshirja sociale	26,500	12,300	0	112,350	124,650	151,150
08480	Mbështetje për kultet fetare	126,610	169,830	0	0	169,830	296,440
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	30,000	97	0	0	97	30,097
26	Ministria e Mjedisit	1,158,300	267,510	419,397	321,082	1,007,989	2,166,289
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	123,400	5,563	0	0	5,563	128,963
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	360,800	66,744	0	198,042	264,786	625,586
04260	Administrimi i pyjeve	543,500	182,603	419,397	50,000	652,000	1,195,500
05640	Administrimi i ujërave	130,600	12,600	0	73,040	85,640	216,240
28	Prokuroria e Përgjithshme	1,413,247	148,000	0	0	148,000	1,561,247
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,413,247	148,000	0	0	148,000	1,561,247
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1,906,200	152,212	0	0	152,212	2,058,412
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	28,380	12,369	0	0	12,369	40,749
03310	Buxheti Gjyqësor	1,877,820	139,843	0	0	139,843	2,017,663
30	Gjykata Kushtetuese	110,000	3,287	0	0	3,287	113,287
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	110,000	3,287	0	0	3,287	113,287
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	93,700	2,500	0	0	2,500	96,200
08320	Veprimtaria telegrafike ATSH-së	93,700	2,500	0	0	2,500	96,200
40	Partitë politike	201,000	0	0	0	0	201,000
01110	Mbështetje për partitë politike	190,000	0	0	0	0	190,000
01120	Mbështetje për shoqatat	9,000	0	0	0	0	9,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteranëve me status	2,000	0	0	0	0	2,000
50	Instituti Statistikës	481,930	7,000	0	70,000	77,000	558,930
01320	Veprimtaria statistikore	481,930	7,000	0	70,000	77,000	558,930
55	Shkolla e Magjistraturës	58,600	1,000	0	0	1,000	59,600
09820	Veprimtaria arsimore	58,600	1,000	0	0	1,000	59,600
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	2,084,266	0	8,000,000	10,084,266	10,084,266
06210	Programe zhvillimi	0	2,084,266	0	8,000,000	10,084,266	10,084,266
57	Qendra Kombëtare Kinematografisë	104,270	2,000	0	0	2,000	106,270
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	104,270	2,000	0	0	2,000	106,270
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	85,920	2,000	0	0	2,000	87,920
03320	Veprimtaria mbikëqërëse KLD-së	85,920	2,000	0	0	2,000	87,920
66	Avokati i Popullit	91,500	4,000	0	36,400	40,400	131,900
03320	Shërbimi i avokatise	91,500	4,000	0	36,400	40,400	131,900
67	Komisioni i Shërbimit Civil	43,670	1,500	0	0	1,500	45,170
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	43,670	1,500	0	0	1,500	45,170
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	88,080	3,000	0	0	3,000	91,080
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	88,080	3,000	0	0	3,000	91,080
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	96,300	10,200	0	0	10,200	106,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	96,300	10,200	0	0	10,200	106,500
77	Autoriteti i Konkurrencës	62,040	1,000	0	0	1,000	63,040
04120	Mbikëqyrja e tregut & garantimi i konkurrencës	62,040	1,000	0	0	1,000	63,040
78	Ministria e Integritimit	140,700	25,540	0	220,000	245,540	386,240
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	44,700	5,180	0	0	5,180	49,880
01140	Drejtesia dhe tregu i brendshëm	45,500	0	0	0	0	45,500
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integritimit	50,500	20,360	0	220,000	240,360	290,860
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	11,660	0	0	0	0	11,660
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	11,660	0	0	0	0	11,660
87	Institucione të tjera qeveritare	1,157,210	492,272	0	0	492,272	1,649,482
01320	Shërbime qeveritare	89,000	28,000	0	0	28,000	117,000
01130	Shërbimi i prokurimit publik	76,000	6,756	0	0	6,756	82,756
01140	Shërbime për shoqërinë e informacionit	755,648	365,700	0	0	365,700	1,121,348
01150	Shërbime të tjera	101,635	55,816	0	0	55,816	157,451
01510	Shërbime për teknologjinë dhe inovacionin	24,900	36,000	0	0	36,000	60,900
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	110,027	0	0	0	0	110,027
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	116,000	746	0	0	746	116,746
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	116,000	746	0	0	746	116,746
89	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	46,000	1,000	0	0	1,000	47,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	46,000	1,000	0	0	1,000	47,000
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	36,500	1,000	0	0	1,000	37,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	36,500	1,000	0	0	1,000	37,500
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	30,800	1,000	0	0	1,000	31,800
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	30,800	1,000	0	0	1,000	31,800
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	798,230	284,274	0	191,000	475,274	1,273,504
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	383,990	107,900	0	191,000	298,900	682,890
04320	Mbështetje për energjinë	12,000	763	0	0	763	12,763
04430	Mbështetje për burimet natyrore	164,200	105,919	0	0	105,919	270,119
04440	Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	238,040	69,692	0	0	69,692	307,732
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	1,305,547	659,001	0	720,000	1,379,001	2,684,548
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	160,492	255,712	0	0	255,712	416,204
06180	Planifikimi urban dhe strehimi	1,014,081	401,037	0	720,000	1,121,037	2,135,118
04760	Zhvillimi i turizmit	130,974	2,252	0	0	2,252	133,226
TOTALI		201,302,660	34,868,690	423,897	29,910,860	65,203,447	266,506,107

**VENDIM****Nr. 915, datë 29.12.2014****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 9, të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet nënndarja me këtë përmbajtje:

“Punonjësve me rezultate të mira në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 921, datë 29.12.2014****PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 3, e 15, pika 3, shkronja “dh”, pika 4, shkronja “ç”, pika 5, shkronja “dh”, pika 6, shkronja “d”, pika 7, shkronja “dh”, pikat 9, 11 e 12, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Pranimi në administratën doganore

1. Personeli pranohet në administratën doganore për pozicionet e punës, që përfshihen

Faqe | 12632

në shërbimin civil nëpërmjet një konkurrimi të hapur, kur këto vende nuk janë plotësuar dhe kanë mbetur të lira edhe pas përmbushjes së procedurave të posaçme, që përshkruhen në këtë vendim, e konkretisht me rend zbritës:

- lëvizjes paralele brenda sistemit doganor;
- ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor;
- lëvizjes paralele në shërbimin civil;
- ngritjes në detyrë në shërbimin civil.

2. Konkurrimi zhvillohet jo vetëm për pozicionet ekzekutive, por dhe për pozicione të tjera, të cilat mbeten të paplotësuara.

3. Drejtoria e Përgjithshme Doganave përgatit kriteret e veçanta për pozicionet e lira dhe ia referon për shpallje Departamentit të Administratës Publike. DAP-i, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga mbërritja e kësaj kërkesë, i shpall ato në portal dhe në faqen e vet zyrtare. Shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së konkurrimit. Dokumentacioni duhet të dorëzohet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga e nesërmja e ditës së shpalljes në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

4. Komiteti i përhershëm i pranimit kryesohet nga një prej nëpunësve të kategorisë së mesme drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka në përbërje:

- a) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
- b) një ekspert të fushës, të përzgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- c) një përfaqësues nga DAP-i;
- ç) një ekspert të fushës, të përzgjedhur nga drejtori i DAP-it.

5. Për pjesën e papërshtatshme të procedurës së pranimit të nëpunësve civilë, për sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij vendimi, e më konkretisht me çështjet, si: të dhënat që përfshihen në shpalljen në portal, listën e dokumenteve që duhet të plotësojë kandidati, mënyrën e funksionimit të komitetit të përhershëm të pranimit, konkurrimin dhe periudhën e provës, zbatohen kërret II-V, të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.



6. Punonjësit administrativë, të cilët nuk përshihen në shërbimin civil, përzgjidhen po ashtu me konkurrim të hapur, sipas rregullores së konkursit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave dhe të miratuar nga ministri i Financave. Komiteti i përhershëm i pranimi për një konkurrim të tillë kryesohet nga një prej nëpunësve të kategorisë së mesme drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka në përbërje:

- a) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
- b) drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të DPD-së.

Fituesve u lidhet kontratë pune, në fillim me periudhë prove 3-mujore dhe, më pas, me afat të pacaktuar.

II. Lëvizja paralele brenda administratës doganore

7. Kur një pozicion në administratën doganore mbetet i lirë, Drejtoria e Përgjithshme Doganave fillon plotësimin e tij me lëvizjen paralele të punonjësve të administratës doganore të së njëjtës kategori/klasë.

8. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurrim;
- ç) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar.

9. Afati për dorëzimin e dokumenteve është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e nesërme shpalljes së njoftimit në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

10. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave krijon komisionin e brendshëm të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, që kryesohet nga një prej nëpunësve të kategorisë së mesme drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe ka në përbërje:

- a) drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;
- b) një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike.

11. Pjesa tjetër e procedurës së lëvizjes paralele, por pa u kufizuar në, si: të dhënat që duhet të përmbajë shpallja në portal, procedura e lëvizjes paralele, lista paraprake verifikimit, e drejta e ankimit, procedura që ndjek komisioni i brendshëm, është sipas kreut VI, të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, për sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij vendimi.

III. Ngritja në detyrë brenda administratës doganore

12. Kur pozicioni i lirë nuk plotësohet me procedurën e lëvizjes paralele, atëherë Drejtoria e Përgjithshme Doganave fillon plotësimin e tij me procedurën e ngritjes në detyrë, vetëm për nëpunësit civilë të administratës doganore të një kategorie paraardhëse.

13. I njëjti komision i parashikuar në pikën 10, të këtij vendimi, zhvillon këtë procedurë. Afati për dorëzimin e dokumenteve është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e nesërme shpalljes së njoftimit në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

14. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurrim;
- ç) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar.

15. Pjesa tjetër e procedurës së ngritjes në detyrë, si dhe pa u kufizuar në: mënyrën e funksionimit të komisionit, strukturën e ndarjes së pikëve të vlerësimit, renditjen e kandidatëve, është sipas kreut VII, të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, për sa nuk bien ndesh me parashikimet e posaçme në këtë vendim.



IV. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për nëpunësit civilë jashtë administratës doganore

16. Nëse pozicioni nuk plotësohet as me procedurën e ngritjes në detyrë me nëpunës civilë brenda administratës doganore, atëherë rihapet procedura e lëvizjes paralele për nëpunës civilë jashtë administratës doganore dhe vijon në rast nevojë me procedurën e ngritjes në detyrë me nëpunës civilë jashtë administratës doganore me afatet, komisionet dhe procedurat e lartpërshkruara.

V. Transferimi i përkohshëm

17. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave bën transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor për shkaqet, që parashikohen në Kodin Doganor. Në rastin e punonjësve doganorë, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, një kopje aktit të transferimit i dërgohet për dijeni Departamentit të Administratës Publike.

18. Procedura e transferimit të përkohshëm fillon me kërkesën e drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ose të eprorit direkt për pozicionin e vartësit që është bosh e, në raste të tjera, kryesisht nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Punonjësi doganor që transferohet ka të drejtë të ankohet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të aktit pranë drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëse ka shkaqe objektive, që e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrës së re. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave i kthen përgjigje punonjësit doganor brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit.

VI. Procedura disiplinore dhe Komisioni Disiplinor

19. Komisioni Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave kryesohet nga një prej nëpunësve civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe ka në përbërje:

a) drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;

b) nëpunësin civil më të vjetër në detyrë, në institucion, sipas fushës që shqyrtohet në komision.

Caktimi nominal i këtyre personave në komision bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

20. Komisioni Disiplinor vihet në lëvizje nga subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe

vepron për nëpunësit civilë dhe për punonjësit administrativë, në lidhje me hetimin administrativ, llojin dhe formën e vendimit, në përputhje me përcaktimin e bërë në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, për sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij vendimi.

21. Komisioni Disiplinor e fton nëpunësin civil apo punonjësin administrativ të japë shpjegimet me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga e nesërmja e njoftimit të tij për aktet e ecurisë disiplinore.

22. Nëpunësi civil apo punonjësi administrativ gjatë afatit dhjetëditor ka këto të drejta:

a) Të njihet me aktet e dosjes;

b) Të paraqesë argumentet e tij me shkrim për shkeljen e pretenduar;

c) Të kërkojë mbajtjen e seancës dëgjimore të hapur për t’u shprehur ai vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

23. Nëse punonjësi doganor nuk shpreh dëshirën për t’u dëgjuar në një seancë të hapur, procedimi disiplinor përmbyllet me shkëmbimin e akteve dhe Komisioni Disiplinor merr vendim bazuar në aktet e administruara, edhe nëse nëpunësi civil apo punonjësi administrativ nuk paraqet shpjegimet e tij me shkrim brenda afatit të caktuar.

24. Seancë dëgjimore mbahet vetëm nëse kërkohet me shkrim nga nëpunësi civil. Një kopje gjithë korrespondencës me nëpunësin civil i përcillet për dijeni DAP-it, bashkë me vendimin e marrë nga Komisioni Disiplinor.

VII. Zbatimi i organizimit të ri, mbylljes apo ristrukturimit të plotë a të pjesshëm të institucionit

25. Me miratimin e një strukturë të re, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ngre komisionin e ristrukturimit për punonjësit administrativë. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përcakton kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë punonjësit për çdo vend të ri pune të krijuar rishtazi apo të rikonceptuar.

26. Kriteret e veçanta për pozicionet që janë në shërbimin civil i përcillen DAP-it, për të vazhduar me procedurat e transferimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.



27. Komisioni i ngritur në DPD bën verifikimet për punonjësit administrativë, nëse janë në përputhje me kriteret e vendit të ri të punës. Nëse konstaton se punonjësi nuk plotëson kriteret e veçanta për vendin e ri të punës, si dhe nëse nuk gjendet në strukturë një vend tjetër pune, për të cilin ai plotëson kriteret, komisioni njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave dhe fillon procedurat përkatëse të parashikuara në Kodin e Punës. Punonjësi administrativ, në një rast të tillë, përfiton dëmshpërblimet, sipas parashikimeve të neneve 141, 143 dhe 144, të Kodit të Punës, si dhe kompensimet e tjera eventuale nëse i ka lindur e drejta për to.

28. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, në rast nevojë dhe urgjence, për t'i shërbyer sa më mirë dhe shpejt biznesit, dërgon punonjës doganorë për të kryer shërbimet doganore atje ku çmohet se ka më shumë efikasitet.

29. Për punonjësit doganorë që gëzojnë statusin e nëpunësit civil për çdo çështje tjetër të parregulluar shprehimisht nga ky vendim zbatohet legjislacioni i shërbimit civil.

VIII. Pagesat për orët jashtë orarit dhe kompensimet për punën larg vendbanimit

30. Punonjësi, i cili, për nevoja të institucionit, detyrohet të kryejë orë pune jashtë kohës normale të punës, kompensohet si rregull me pushim dhe, në rast pamundësie, me pagesë shtesë për orët jashtë orarit.

31. Punonjësit, që emërohet apo transferohet larg vendbanimit a vendqëndrimit të tij të zakonshëm, i sigurohet banesë ose një pagesë si kompensim për strehimin sipas legjislacionit në fuqi.

IX. Dispozita tranzitore

32. Punonjësit administrativë, që nuk përfshihen në shërbimin civil dhe që janë të punësuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Doganor, pa procedurë konkurruese apo me procedurë konkurruese të vitit 2013, konsiderohen në periudhë prove për 3 (tre) muaj duke filluar nga e nesërmja e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

X. Shfuqizime

33. Nenet 11 - 13 dhe nenet 16 - 19, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 922, datë 29.12.2014

PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 65, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dorëzimin e detyrueshëm, vetëm nëpërmjet formës elektronike, të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, objekt i këtij vendimi, me të cilat nënkuptohen:

Deklarata tatimore, në kuptim të këtij vendimi, janë :

- i) formulari i deklarimit të TVSH-së;
- ii) formulari i deklarimit të tatimit mbi fitimin;
- iii) formulari i të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe i të larguarve nga puna;
- iv) formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- v) formulari i deklarimit të tatimit, të mbajtur në burim, mbi të ardhurat;
- vi) formulari i deklarimit të tatimit mbi lojërat e fatit;
- vii) formulari i deklarimit të taksës së rentës minerare;
- viii) formulari i deklarimit të taksave kombëtare;
- ix) formulari i deklarimit të tarifave kombëtare;
- x) formulari D1 - deklarata individuale vjetore të ardhurave;
- xi) formulari D2 - deklarata individuale vjetore të ardhurave për individët e huaj;
- xii) deklarata "Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi".

Forma dhe përmbajtja e deklarave tatimore të sipërpërmendura përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.



b) Dokumente tatimore, në kuptim të këtij vendimi, janë:

i) librat e shitjes së tatimpaguesve, të regjistruar për TVSH-në;

ii) librat e blerjes së tatimpaguesve, të regjistruar për TVSH-në;

iii) pasqyrat financiare vjetore, shënimet shpjeguese dhe tabelat shoqëruese;

iv) vendimi për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit pas tatimit.

2. Çdo tatimpagues është i detyruar të bëjë dorëzimin e deklarave dhe dokumenteve tatimore, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, vetëm nëpërmjet formës elektronike, duke filluar nga data 1 janar 2015, sipas afateve ligjore të përcaktuara dhe formës së deklaratës apo të dokumentit të miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.

3. Për identifikimin e punonjësve, që deklarohen në deklaratë, përdoret numri personal i letërnjoftimit të çdo individ, sipas ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin e shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar. Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit, me udhëzime të përbashkëta, të përcaktojnë rregullat e komunikimit on-line për përdorimin e bazës së të dhënave për numrin personal të letërnjoftimit të shtetasve. Ndërkohë, vetëm për punonjësit e huaj të përdoret numri i sigurimit dhe, në rastet kur nuk ekziston një i të tillë, të përdoret numri i identifikimit personal, që punonjësi ka në pasaportën e tij.

4. Në zbatim të këtij vendimi, Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës, Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, në bashkëpunim ndërmjet tyre dhe në mënyrë të pavarur, sipas përkatësisë, të përcaktojnë nomenklaturën dhe procedurat për shkëmbimin e të dhënave, certifikimin dhe transmetimin elektronik të tyre, rregullat e përpunimit të të dhënave si dhe të ruajtjes në regjistra elektronike të historikut të kontributeve të paguara dhe të fondit të pagave, për çdo tatimpagues dhe individ.

5. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, organet tatimore të dërgojnë në organet e sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve të kujdesit shëndetësor, në mënyrë periodike, të dhënat e deklaratës “Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, në total dhe për çdo individ, vetëm në format elektronik. Organet tatimore të dërgojnë, gjithashtu, në Inspektoratin Shtetëror të Punës, deklaratën “Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe formularin e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi si dhe të të larguarve nga puna.

6. Vendimi nr. 55, datë 3.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 923, datë 29.12.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 783, DATË 10.11.2011, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E
NDARJES TË TË ARDHURAVE TË
TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË
PËRDORURA ME NJËSITË E
QEVERISJES VENDORE”, TË
NDARSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e vendimit nr. 783, datë 10.11.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:



“1. Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor së bashku me drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor në varësi të saj, të caktuara me ligj si agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, deklarojnë dhe paguajnë taksën brenda datës 15 të muajt pasardhës, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit të Financave.

Për periudhën tatimore dhjetor 2014, deklarimi dhe pagesa e kësaj takse për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore bëhet brenda datës 15 janar 2015.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 924, datë 29.12.2014

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2015, PËR
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2015, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike Postare, në shumën 306 400 000 (treqind e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekë, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

**STRUKTURA E PROJEKTFONDIT TË
SHPENZIMEVE PËR VITIN 2015 TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzimet gjithsej:	306,400,000
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	72,000,000
2.	Kontributi i sigurimeve shoqërore shëndetësore	9,700,000
3.	Shpenzime për materiale	5,800,000
4.	Shpenzime për shërbime	51,740,000
5.	Investime	167,160,000

VENDIM
Nr. 925, datë 29.12.2014

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 634, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE
DHËNIEN ME KONCESION/
PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË
PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE
PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN
E RRUGËVE NACIONALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, shkronja “j” e 2, dhe 49, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin “Rregullat për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, bashkëlidhur vendimit nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) pas paragrafit të parë, të nenit 24, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Seti i dokumenteve standarde të procedurës konkurruese dhe kontrata tip janë pjesë integrale këtyre rregullave dhe i bashkëlidhen si aneksi 1.”.

b) Në fund të tekstit të rregullave bashkëlidhet Aneksi 1, “Dokumentet standarde



të koncesionit/partneritetit publik privat të punëve publike dhe shërbimeve, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, si pjesë e këtyre rregullave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

DOKUMENTET STANDARDE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT TË
PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE, PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, _____, 2014

NJOFTIMI I KONTRATËS

Autoriteti Kontraktues, adresa, nr. tel :

Lloji i procedurës konkurruese:

Objekti i procedurës konkurruese :

Afati i koncesionit / PPP:

Data e zhvillimit të procedurës konkurruese

Vendi: Faqja zyrtare e Agjencisë së Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>

Afati i fundit për pranimin e dokumentave (Data):

Vendi: _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

**NJOFTIMI I KONTRATËS****Seksioni I Autoriteti Kontraktues****I.1 Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues**

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa e Internetit _____

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____

I.3 Lloji i autoritetit Kontraktues

Institucion qendror

**Seksioni II Objekti i kontratës****II.1 Lloji i Kontratës**

Koncesion / PPP

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Forma e Kontratës:
2. Objekti i kontratës:

**II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**Kohëzgjatja në

ose

duke filluar nga // me përfundim në /**II.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:**

II.5 Ndarja në LOTE:Po ☐ Jo ☐

Nese po

II.6 Përshkrim i shkurtër i loteve1.

2.

3.

Etj.

II.7 Opsionet:Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka): ose: nga në **II.8 Do të pranohen variantet:**Po ☐ Jo ☐**II.9 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër**Po ☐ Jo ☐

**Seksioni III Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik****III.1 Kriteret e Pranimit****III.2 Sigurimi i ofertës:**

Që një Operator Ekonomik të marrë pjesë në një procedurë konkurimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 6. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës do të përcaktohet në dokumentat e procedurës konkurruese rast pas rasti por jo më shumë se 2 % e vlerës së projektit.

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

Loti 2 _____ Lekë

Seksioni IV Procedura**IV.1 Lloji i procedurës:**

- ☐ E Hapur
- ☐ E kufizuar

IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta më e mirë bazuar në:

Informacione të mëtejshme në DPK.

IV.3 Afati kohor për dorëzimin e kërkesës për kualifikim:

Data: _____ Ora: _____

Vendi: **Faqja zyrtare e Agjencisë së Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>**

Kur kërkesa për kualifikim kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

**IV.4 Afati kohor për hapjen e kërkesës për kualifikim:**

Data: _____ Ora: _____

Vendi: _____

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes të kërkesave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesa, në bazë të kërkesës së tyre. Afatet për fazat e tjera të procedurës do t'u komunikohen të gjithë të interesuarve mbas përfundimit të fazës së parakualifikimit.

IV.5 Periudha e vlefshmërisë së propozimit: (e shprehur në ditë)**IV.6 Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe kërkesës për kualifikim:**

Shqip ☐ Anglisht ☐
Tjetër _____

Seksioni V Informacione plotësuese**V.I Informacione shtesë (vendi, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

Faqja zyrtare e Autoritetit Kontraktues, ose dokumentet e procedurës konkurruese mund të shkarkohen falas në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi _____



2. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT KONKURRUESE

Autoriteti Kontraktues mund të zbatojë procedurën konkurruese në mënyrat e mëposhtme:

- i) E kufizuar, ose
- ii) E Hapur

PROCEDURA E KUFIZUAR

Autoriteti Kontraktues do të zhvillojë procedurën konkurruese në dy faza:

- i) Kërkesa për Parakualifikim
- ii) Kërkesa për Propozim.

i) KËRKESË PËR PARAKUALIFIKIM

Autoriteti Kontraktues

[shkruani emrin e autoritetit Kontraktues]

Publikon ftesën për parakualifikim duke ftuar të gjithë operatorët ekonomikë të paraqesin kërkesat për parakualifikim në këtë procedurë konkurruese me qëllim realizimin e shërbimeve/punëve të përshkruara më poshtë:

“Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe rehabilitim i rrugëve nacionale - _____”

[jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës, duke përfshirë në të informacionet bazë për lotet], siç përkufizohet në DPK.

Kërkesa për Parakualifikim:

- (i) Kandidatët do të dorëzojnë kërkesë për parakualifikim pranë Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues, do të shqyrtojë kërkesat për parakualifikim të dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë për t'u siguruar nëse ato dhe dokumentacioni shoqërues plotësojnë dhe janë në përputhje me kriteret e parakualifikimit të përcaktuara në DPK. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e parakualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen për këtë skualifikim.

(ii) Kërkesa për Propozim

- a) Oferta teknike (nëse është e aplikueshme):

Oferta teknike mund të përmbajë projekte, përshkrime të punëve ndërtimore, programe të operimit dhe administrimit, përshkrimin e metodologjisë së punimeve në drejtim të stabilizimit të shpateve, etj. Kandidatët e parakualifikuar në përputhje me kriteret e specifikuar në pikën (i) të Kërkesës për



Parakualifikim më lart ftohen për të paraqitur propozimin teknik, kur ky propozim është i aplikueshëm, dhe përgatitjen e ofertës financiare. Propozimet teknike të paraqitura do të vlerësohen bazuar në kriteret dhe procedurën e përcaktuar në DPK, dhe ofertuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues do të njoftohen për të paraqitur ofertën financiare, ndërsa kandidatët që nuk i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues do të skualifikohen, por do t'ju vihet në dispozicion formulari i vlerësimit të propozimin teknik, nëse kërkohet.

b) Oferta Financiare:

Pas shqyrtimit nga Autoriteti Kontraktues, kandidatët që përmbushin kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues sipas pikës (ii) a) më sipër, paraqesin ofertën financiare sipas afateve të përcaktuara në DPK.

Kandidatët e parakualifikuar për rastet kur nuk aplikohet kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike, pas marrjes së kërkesës për propozim do të paraqesin ofertën financiare sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e procedurës konkurruese.

Kandidatët që kanë marrë kërkesën për propozim (për të paraqitur ofertë financiare), duhet të paraqesin gjithashtu sigurimin e ofertës dhe vendimin e bordit si dhe dokumentet e tjerë ligjorë sic përcaktohet në dokumentet e procedurës konkurruese.

Ofertat financiare do të klasifikohen në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese. Autoriteti Kontraktues fton ofertuesin që ka paraqitur ofertën më të mirë të vlerësuar dhe që është shpallur fitues për të filluar negocimin e kontratës.

ii) PROCEDURA E HAPUR

Autoriteti Kontraktues

[shkruani emrin e autoritetit Kontraktues]

Publikon ftesën për propozim duke ftuar të gjithë operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre në këtë procedurë konkurruese me qëllim realizimin e shërbimeve/punëve të përshkruara më poshtë:

“Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe rehabilitim i rrugëve nacionale - _____”

[jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës, duke përfshirë në të informacionet bazë për lotet], siç përkufizohet në DPK.

Kërkesa për propozim

- (i) Kandidatët do të dorëzojnë propozimin sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e procedurës konkurruese. Autoriteti Kontraktues, do të shqyrtojë propozimet e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat ligjore, tekniko-ekonomike, propozimi teknik, nëse është i aplikueshëm, sigurimin e ofertës dhe vendimin e bordit si dhe ofertën financiare sipas përcaktimeve të bëra në DPK. Kandidatët, që nuk plotësojnë kriteret ligjore, tekniko-ekonomike, si dhe nuk përmbushin kriteret për propozimet teknike, nëse është e aplikueshme, dhe nëse nuk paraqesin sigurimin e ofertës dhe vendimin e bordit, skualifikohen dhe njoftohen për këtë skualifikim si dhe ju kthehet



oferta financiare e pa hapur. Oferta financiare do të jetë objekt vlerësimi vetëm për ata kandidatë të cilët përmbushin kriteret ligjore, tekniko-ekonomike dhe kriteret për propozimet teknike, nëse janë te aplikueshme.

OPSION [në rastet e loteve]

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot] [të gjitha lotet] [disa lote]. Për cdo lot paraqitet një ofertë e vecantë.

.....
.....
.....
.....
.....

Për t'u ftuar në procedurën konkurruese kandidatët duhet të plotësojnë minimalisht kërkesat e përcaktuara në Shtojcën.....;

Kërkesat për kualifikim nga operatorët ekonomikë duhet të paraqiten

Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>

Përpara

Datë ora [përcaktoni datën dhe kohën e afatit përfundimtar]

Kur kërkesa për kualifikim kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al



3. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKE

Hartimi i kërkesës/Propozimit

- 3.1 Kandidatët/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesat/propozimet, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DPK. Kërkesat/propozimet që nuk përgatiten në përputhje me DPK do të refuzohen si të papranueshme.
- 3.2 Kandidatët/Ofertuesit e mundshëm përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave/propozimeve të tyre. Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 3.3 Për procedurat konkurruese që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numërohen. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertës, përveç literaturës së pa-ndryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar.
- 3.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personin (-at) e Autorizuar, që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës konkurruese. Operatori ekonomik, pjestar i një bashkimi operatorësh nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe ofertë individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës dhe përpara shpalljes së ofertuesit fitues, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Shtimi i anëtarëve të tjerë në përbërjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë është i mundshëm në çdo kohë, vetëm me aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Kërkesat e parashikuara në këtë pikë duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë përpara datës së caktuar për paraqitjen e ofertës ekonomike. Ndryshimet në përbërjen e bashkimit të operatorëve ekonomik deri në momentin kur është e lejueshme sipas DPK, duhet të reflektohen në një marrëveshje të re të bashkimit të operatorëve ekonomik. Zëvendësimi i një apo më shumë anëtarëve të bashkimit të operatorëve lejohet nëse anëtarët zëvendësues i përkasin kandidatëve që kanë qënë pjesë e procedurës parakualifikuese. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë secili më vete kërkesat ligjore të përcaktuara në DPK. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku.

4. FAZA I –KUALIFIKIMI (Lista e shkurtër)

Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e kërkesave për kualifikim

- 4.1 Afati kohor për paraqitjen e kërkesave për kualifikim skadon më _____ ora ____.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm në hapjen e kërkesave.



Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të kërkesave që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesa, në bazë të përcaktimeve të bëra në DPK.

- 4.2 Kërkesat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Kërkesat për parakualifikim do të dorëzohen në rrugë elektronike, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

5. FAZA II - DORËZIMI I OFERTAVE TEKNIKE/FINANCIARE

- 5.1 Dorëzimi i propozimit teknik:

Dorëzimi i propozimit teknik do të bëhet në rrugë shkresore dhe operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm propozimin teknik origjinal të futur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe nënshkruar në emrin dhe adresën e kandidatit dhe të shënuar: “Propozim teknik për procedurën _____

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS. DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv), _____ orë”.

- 5.2 Vetëm operatorët që përmbushin kritere sipas shtojcës..... do të ftohen për paraqitjen dokumentacionit të kërkuar për fazat vijuese të procedurës.

- 5.3 Ofertat teknike dhe/ose financiare do të dorëzohen vetem nga kandidatët që kanë marrë një kërkesë për ofertë nga Autoriteti Kontraktues.

Dorëzimi i ofertës financiare:

- 5.4 Oferta Financiare do të dorëzohet sipas formatit të dhënë në Shtojcën

- 5.5 Çdo operator ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

- 5.6 Ofertat do të dorëzohen në rrugë shkresore. Oferta origjinale do të dorëzohet në zarf jo transparent , të vulosur dhe nënshkruar me emrin dhe adresën e Ofertuesit të shënuar:

“Propozim ;



“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS DHE JO PARA _____

5.7 Oferta duhet të përmbajë gjithashtu në një zarf të vecantë, dokumentet e mëposhtme:

- 1- Sigurimi i ofertës
- 2- Vendimi i Bordit
- 3- Prokura e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik në favor të përfaqësuesve (nëse përfaqësuesi nuk është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjen e krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomik).
- 4- Konfirmimi i pranimit të kushteve të përgjithshme dhe të vecanta të kontratës
- 5- Deklaratën e operatorëve ekonomikë se nuk ka patur ndryshime në lidhje me informacionin e dhënë në fazën kualifikuese (në rast të procedurës me dy faza); të cilat do të hapen përpara se të hapet zarfi i cili përmban ofertën financiare.
- 6- Marrëveshja e bashkimit të operatorëve ekonomik (në rast se ka pësuar ndryshime.)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dokumentat e mësipërme të paraqitura nga operatorët ekonomikë për përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e DPK dhe njofton operatorët ekonomikë që do të mund të vijojnë më tej procedurën për dorëzimin e ofertës financiare brenda afateve të përcaktuara në DPK, nëse oferta financiare nuk do të kërkohej të paraqitet njëkohësisht me propozimin teknik.

Në procedurën e hapur, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin ligjor, përmbushjen e kërkesave tekniko-ekonomike, ofertën teknike, nësë e aplikueshme, si dhe ofertën financiare sipas përcaktimeve të bëra në DPK.

Afati kohor për paraqitjen e propozimit skadon më _____ ora ____.

5.8 Ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin propozimet e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e propozimeve. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktues me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e propozimeve. Rrjedhimisht, zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM PROPOZIMI ”** ose **“TËRHEQJE PROPOZIMI ”**.

Sigurimi i ofertës

5.9 Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktues sipas përcaktimeve të bëra në DPK, në çdo rast jo më parë se 2 muaj nga njoftimi i ofertuesve të parakualifikuar për



paraqitjen e ofertës dhe jo më vonë se 2 ditë përpara dorëzimit të formularit të ofertës ekonomike.

5.10 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar.

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (banka) dhe duhet të dorëzohet para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

5.11 Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë rast pas rasti zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës. Autoriteti Kontraktues ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

5.12 Vendimi i bordit duhet të përmbajë minimalisht:

- a) Konfirmimin për pjesëmarrje në procedurën konkurruese dhe dorëzimin e ofertës financiare;
- b) Autorizimin me fuqi të plotë të personit që paraqet dhe nënshkruan ofertën.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

5.13 Ofertat duhet të jenë të vlefshme për _____ (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertës. Periudha e vlefshmërisë së ofertave fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim, duhet të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të paraqesë një sigurim oferte të zgjatur. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk arrin t'i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk bën zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, ose nuk arrin të paraqesë një sigurim të zgjatur të ofertës, atëherë do të konsiderohet se Ofertuesi e ka refuzuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues do të refuzojë ofertën.

5.14 Veprimet e kundraligjshme

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nëse Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit; dhe/ose
- ii) është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues kontrollon nga një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve,



specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- iii) Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurimit.

6. VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

Afati në dispozicion për Autoritetin Kontraktues për nxjerrjen e rezultateve të fazës së parakualifikimit do të jetë jo më shumë se 60 ditë. Ndërsa për fazën e vlerësimit të propozimeve teknike do të jetë jo më shumë se 30 ditë (nese aplikohet), ndërsa afati për shqyrtimin e ofertave financiare do të përcaktohet në dokumentet e procedurës konkurruese.

Hapja e propozimit teknik

- 6.1 Pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktues, ofertuesi do të paraqesi propozimet teknike, nëse është e aplikueshme, në ditën dhe orën e caktuar.

Vlerësimi i Propozimeve Teknike

- 6.2 Autoriteti Kontraktues shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në DPK dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson kriteret e përcaktuara, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në DPK, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktues vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në DPK. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në DPK. Nëse DPK parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

Hapja e ofertës financiare

- 6.3 Pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktues, ofertuesi do të paraqesë ofertën financiare, në vendin, ditën dhe orën e caktuar dhe hapja e ofertës financiare do të bëhet sipas përcaktimeve të DPK

Vlerësimi i ofertës financiare

- 6.4 Autoriteti Kontraktues përcakton nëse ofertat financiare janë të plota, korrigjon ndonjë gabim aritmetik dhe për qëllime krahasimi e vlerësimi, i konverton të gjitha çmimet e propozimit në një monedhë të vetme. Autoriteti Kontraktues rendit dhe cakton një rezultat për çdo ofertë financiare.



Kriteret e vlerësimit

6.5 Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit

.....

Total (Propozimi Teknik)

100%

- **Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e ofertës financiare, është pikë.**
- **Nëse vlerësimi bëhet me mënyrën “kalon/ngel”, nuk do të ketë vlerësim me pikë.**

Vlerësimi i Propozimeve Financiare kryhet sipas formulae se mëposhtme:

.....

Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë nga vlerësimi i ofertave do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

6.6 Autoriteti Kontraktues korrigjon ato gabime në ofertë/propozim, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave/propozimeve. Autoriteti Kontraktues njofton Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta/propozimi do të refuzohet, duke i'a konfiskuar sigurimin e ofertës..

6.7 Gabimet në llogaritjen e ofertës do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktues, sipas shëmbujve të mëposhtme:

- a) në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të kenë përparësi shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
- b) nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të ketë përparësi çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total,
- c) nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të ketë përparësi nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet.



Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet dhe do t'i mbahet sigurimi i ofertës. Refuzimi i korigjimeve të gabimeve do të konsiderohet nga Autoriteti Kontraktues si terheqje e ofertës. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

7. Ankimi administrativ do të ushtrohet sipas përcaktimeve të bëra në VKM 634 datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet public privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”

.8. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

- 8.1 Autoriteti Kontraktues njofton Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të njoftimit të shpalljes fitues, siç parashikohet në Shtojcën 15 Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në shtojcën 18.

Sigurimi i kontratës

- 8.2 Autoriteti Kontraktues kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit të kontratës në secilin vit kontraktual do të jetë 10 % e kostos së kryerjes së shërbimeve [dhe punëve] për atë vit kontraktual . Formulari i Sigurimit të Kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 19 e DPK, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.
- 8.3 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës që do të dorëzohet duhet të jetë në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar.
- 8.4 Në përputhje me shtojcën..., pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues dërgon një njoftim për Publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.



9. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DSPK:

Shtojca 1:	Formulari për paraqitjen e Kërkesës për Parakualifikim
Shtojca 2:	Kërkesa për propozim
Shtojca 3:	Formulari i Deklarimit të Ofertës
Shtojca 4:	Formulari i Ofertës Financiare
Shtojca 5:	Formulari i Propozimit Teknik
Shtojca 6:	Formulari i sigurimit të ofertës
Shtojca 7:	Formulari i informacionit konfidencial
Shtojca 8:	Deklarata për konflikt interesi
Shtojca 9:	Kriteret e pranimit/parakualifikimit
Shtojca 10:	Vetwdeklarim mbi gjendjen gjyqësore
Shtojca 11:	Specifikimet teknike
Shtojca 12:	Sherbimet dhe grafiku i ekzekutimit
Shtojca 13:	Termat e references
Shtojca 14:	Formulari i njoftimit të skualifikimit
Shtojca 15:	Formulari i njoftimit të fituesit
Shtojca 16:	Kushtet e përgjithshme të kontratës
Shtojca 17:	Kushtet e vecanta të kontratës
Shtojca 18:	Njoftim i nënshkrimit të kontratës
Shtojca 19:	Formulari i sigurimit të kontratës
Shtojca 20:	Formulari i ankesës në autoritetin Kontraktues

**Shtojca 1 FORMULARI PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR
PARAKUALIFIKIM**

[*Shtojce per tu plotesuar nga operatori ekonomik*]

Koncesioni/PPP: [_____]

Datë: [_____]

Në Lidhje me:

Koncesionin/PPP [_____]

Drejtuar: [_____]
[_____]

Në përputhje me Kërkesën për Parakualifikim, datë [*data e Kërkesës për parakualifikim*], [*emri i Ofertuesit të Mundshëm*] dorëzon Kërkesën për parakualifikim në përputhje me Kërkesën për parakualifikim dhe kërkesat që duhen shqyrtuar për parakualifikim.

[*emri i Ofertuesit të Mundshëm*] me anë të kësaj kërkon të bëhet një Ofertues i Parakualifikuar në Ftesën për oferta për Projektin.

[*emri i Ofertuesit të Mundshëm*] me anë të kësaj konfirmon se:

- (a) Pranon t'u përmbahet të gjitha rregullave të procedurës konkurruese, ligjeve dhe rregulloreve që drejtojnë procedurën konkurruese, sikundër janë nxjerrë nga autoritetet përkatëse kohë pas kohe;
- (b) I njeh të drejtën Komisionit e Vlerësimit të Ofertave për të (i) kërkuar informacionin e nevojshëm në mënyrë të arsyeshme, për të vlerësuar kërkesën, (ii) amenduar procedurat dhe rregullat ose për të bërë sqarime rreth tyre, dhe (iii) për të zgjidhur ose ndryshuar afatin e parakualifikimit dhe të procedurës konkurruese; dhe
- (c) Pranon zbatimin ekskluziv të ligjit shqiptar në lidhje me këto procedura të parakualifikimit.

[*emri i Ofertuesit të Mundshëm*] përfaqëson dhe garanton se deri në datën e kësaj letre:

- (a) I gjithë informacioni i paraqitur në këtë Kërkesë për parakualifikim, duke përfshirë formularët dhe dokumentet e përfshira në të, janë të sakta në të gjitha aspektet;
- (b) [*emri i Ofertuesit të Mundshëm*] [duke përfshirë çdonjërin anëtar të Bashkimit të Shoqërive] nuk i është (janë) nënshtruar asnjë procedure, me vullnetin e tyre ose jo, të falimentimit apo paaftësisë paguese ose procedurave të ngjashme, gjatë pesë vjetëve të fundit; dhe



- (c) [emri i Ofertuesit të Mundshëm] [duke përfshirë çdonjërin anëtar të Bashkimit të Shoqërive] ka(kanë) paguar të gjitha detyrimet tatimore, me përjashtim të atyre që janë duke u kontestuar me mirëbesim nga procedurat e duhura dhe për të cilat janë krijuar rezerva të përshtatshme.

Bashkëngjitur kësaj Kërkese për parakualifikim paraqesim dokumentet e mëposhtme:

- (a) Prokura e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik në favor të përfaqësuesve (nëse përfaqësuesi nuk është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjen e krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomik).
- (b) Vërtetimi i noterizuar (Shtojca)
- (c) Dokumente të tjera të kërkuara Kërkesen për parakualifikim
- (d) ...
- (e)

[emri i Ofertuesit të Mundshëm] me anë të kësaj emëron [_____] si përfaqësuesin e tij për të marrë njoftime në lidhje me parakualifikimin dhe procedurën konkurruese në adresën e mëposhtme, me numra telefoni dhe faksimile.

[_____]

Në datë [_____]

[firma]

Në cilësinë e [postë]

I autorizuar për të nënshkruar këtë Kërkese për Parakualifikim për [emri i Ofertuesit të Mundshëm]

**Shtojca 2**

[Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti Kontraktues]

KËRKESË PËR PROPOZIM

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për parakualifikim)

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

Procedura Konkurruese: _____

Vendi i objektit te koncesionit/PPP

Afati i Kontratës se Koncesionit

Objekti i Koncesionit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të kapaciteteve tuaja ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, kërkesa juaj për pjesëmarrje është pranuar në këtë procedurë konkurruese

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [këtij autoriteti Kontraktues]

Emri _____

Adresa _____

propozimin tuaj Teknik (nëse është i zbatueshëm) dhe Oferten Financiare, duke marrë parasysh se:

Afati kohor për dorëzimin e propozimit

Teknik (nese zbatohet)

Data, ora dhe adresa

Data □□/□□/□□□□ (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____

Afati kohor për hapjen e propozimeve tekinke (nëse zbatohet)është:

Data, ora dhe adresa

Data □□/□□/□□□□ (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____



Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të propozimit, duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozimin, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:

Shqip ☐ Anglisht ☐
Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së :

Autoriteti Kontraktues rendit propozimet sipas vlerësimit teknik që i është bërë secilit, duke bazuar në kriteret treguar në DPK. Ofertuesit që arrijnë rezultatin më të lartë teknik do të ftohen për paraqitjen e ofertës financiare, vlerësimi të cilës cila do të bëhet sipas kriterëve të përcaktara në DPK. Autoriteti Kontraktues është i lirë të vendosë kriteret e vlerësimit të propozimit teknik, vlerësimi i të cilave mund të bëhet edhe nëpërmjet metodës kalon/ngel.

Oferta Financiare

Data, ora dhe adresa

Data / / (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____

Afati i Vlefshmërisë së Ofertës Financiare do të jetë: _____.

Afati kohor për hapjen e Ofertave Financiare është:

Data, ora dhe adresa

Data / / (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të Ofertës Financiare, duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar Ofertën Financiare.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.



Shtojcë 3

FORMULARI I DEKLARIMIT TË OFERTËS

Nga: [Vendosni emrin e Ofertuesit]

Data _____

Për : Vendosni emrin e Autoritetit Kontraktues
AdresaPërshkrim: **Mbi ofertën e** [vendosni emrin e ofertuesit] në procedurën konkurruese për
....., të shpallur nga Autoriteti Kontraktues, më datë
____.____.2014.

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar dokumentat e procedurës konkurruese dhe pranojmë, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në DPK;
2. Ne i përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, të përcaktuara në dokumentat standarte të procedurës konkurruese, dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;
3. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat standarte të procedurës konkurruese;
4. Nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë;
5. Ne autorizojmë Autoritetin Kontraktues të verifikojë informacionin/ dokumentat, që i bashkëlidhen kësaj oferte;
6. Në rast se oferta jonë pranohet, ne do të bëjmë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e procedurës konkurruese;
7. Në rast se shpallemi fitues të procedurës konkurruese, biem dakord për të nënshkruar Kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës.
8. Kuptojmë se ju mund ta anuloni Procedurën Konkurruese në çdo kohë dhe se nuk jeni të detyruar të pranoni ndonjë Ofertë që mund të merrni dhe as të ftoni Ofertuesit të paraqesin ofertë për Projektin pa pasur ndonjë përgjegjësi ndaj Ofertuesit, sic parashikohet në paragrafin [] të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Ne biem dakord dhe kuptojmë se Oferta i nënshtohet dispozitave të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Në asnjë rast nuk do të kemi ndonjë pretendim ose të drejtë të çfarëdo natyre nëse ne nuk na akordohet Konkensionimi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**Shtojca 4 FORMULARI I OFERTËS FINANCIARE**

Ref: []

Datë: []

Për: [Autoritetin Kontraktues]

Procedura Konkurruese:

Përshkrimi i shkurtër i Koncesionit:

Duke iu referuar procedurës konkurruese së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit deklarojmë se:
Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës konkurruese, paraqesim si pjesë të Propozimit tonë
Financiar sa më poshtë:

.....

.....

(Autoriteti Kontraktues mund të vendosë kritere të ndryshme për përcaktimin e cmimit të
ofertës si p.sh. tarifën e koncesionit, taksën rrugore, vlerën e subvencionit, etj.)

Anëtar i Bashkimit të Përkohshëm:

Nënshkrimi:

Vula:

Shënim:

1. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kerkuar ne dokumentat e procedurës konkurruese)



Shtojca 5

FORMULARI I PROPOZIMIT TEKNIK

Ref: []

Datë: []

Për: [Autoritetin Kontraktues]

Procedura Konkurruese:

Përshkrimi i shkurtër i Koncesionit:

Duke iu referuar procedurës konkurruese së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit deklarojmë se:

Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës konkurruese, paraqesim si pjesë të Propozimit tonë Teknik sa më poshtë:

.....
.....

Anëtar i Bashkimit të Përkohshëm:

Nënshkrimi:

Vula:

**Shtojca 6**

[Letër me logon e Bankës]

[Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Garanci Bankare

Nr. ref. Datë []

Përfituesi:[Autoriteti Kontraktues]

Jemi informuar se _____ (këtu e më poshtë referuar si "Ofertuesi") i është kërkuar prej jush të dorëzojë përpara Autoritetit Kontraktues Sigurimin e Ofertës në shumë prej [shuma e shprehur në shifra dhe fjalë] si kusht për Sigurimin e Ofertës për [Autoritetin Kontraktues] në lidhje me Projektin e Koncesionit/PPP [-].

Për me tepër, kuptojmë se sipas kushteve tuaja, ofertat duhet të mbështeten nga një garanci oferte.

Banka merr përsipë të transferojë në llogarinë e [Autoritetit Kontraktues] këtë garanci bankare nëse:

- a) Ofertuesi e ka tërqehur ofertën gjatë afatit të vlefshmërisë së saj;
- b) Ofertuesi nuk ka paraqitur Sigurimin e Kontratës sic kërkohet në dokumentat e procedurës konkurruese;
- c) Nuk e nënshkruan Kontratën e Koncesionit brenda afateve të përcaktuara në Njoftimin e Shpalljes së Ofertuesit të Përzgjedhur;
- d) Ofertuesi ka ofruar ose është përpjekur të ofrojë çdo lloj shpërblimi nënpunësve të Autoritetit Kontraktues që lidhen me Projektin;
- e) Ofertuesi ka bërë deklaratat të rreme në Ofertën e tij;
- f) Ofertuesi nuk ka kryer pagesat në përputhje me kërkesat e dokumenteve të procedurës konkurruese brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues;

Brenda..... (numri i ditëve me shkrim) ditëve nga dorëzimi i kërkesës së parë me shkrim nga Autoriteti Kontraktues dhe pa kërkuar ndonjë shpjegim tjetër, me kusht që kërkesa të përcaktojë mos përmbushjen e një prej kushteve të mësipërme.

Ky sigurim është i vlefshëm deri (numri i ditëve me shkrim) ditë (përfshi ditën e fundit) pas afatit të vlefshmërisë së Ofertes dhe çdo kërkesë në lidhje me këtë duhet ti dërgohet Bankës jo më vonë se data e sipërpërmendur.

Nënshkrimi dhe vula e Bankës

**Shtojca 7****LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri faqes dhe pikat e DPK që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial



Shtojca 8

[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën konkurruese, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ me objekt _____

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrit, ose zvministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.**



Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/PARAKUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet Kontraktuese. Keto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Të gjithë dokumentet e lëshuara nga organet publike apo shtetërore të një shteti të huaj duhet të jenë të legalizuara apo duhet të përmbajnë vulën “Apostille” sipas kërkesave të Ligjit nr. 9060, datë 08.05. 2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtare të huaja”

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.



Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operatoreve ekonomik eshte krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posacme e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik në favor të përfaqësuesve (nëse përfaqësuesi nuk është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjen e krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomik).

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar duhet të paraqesin:

Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojces ;

Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,

-Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e kërkuara më sipër në shtojcën ”**kriteret e përgjithshme të pranimit / parakualifikimit**”

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Kopje të çertifikuar të bilancit financiare për 2 vitet e fundit, të paraqitur në autoritetet përkatëse.

Kapaciteti teknik:

- Ofertuesit duhet të kenë realizuar një kontratë të ngjashme me objektin e procedurës konkurruese, me vlerë jo më të vogël se 50.....% së vlerës së kriterit të përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese, dhe që është realizuar me sukses gjatë 10. viteve të fundit. Kjo të vërtetohet me deshmi, certifikata dokumenta për realizimin e tyre.

Bashkimi i Perkohshëm :

Në rastet e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i këtij bashkimi duhet të përmbahet VKM 634 Datë .1.10.2014 ”Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ PPP të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të njësuara me origjinalin. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojce 10**

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

Datë

VETËDEKLARIM MBI GJENDJEN GJYQËSORE**Për:**

[Emri i Ofertuesit /Anëtari Kryesues i Bashkimit të Përkohshëm] deklaroj dhe garantoj që, në datën e kësaj letre [Emri i Ofertuesit /Anëtari Kryesues i Bashkimit të Përkohshëm] dhe cdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm (kur është rasti)

- (a) nuk i është nënshtruar procedurave të falimentimit ose likuidimit;
- (b) nuk është dënuar me Vendim të Gjykatës së Formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;
- (c) kapitalet/aktivet nuk janë objekt i ndonje procedure ekzekutim te detyrueshëmi;
- (d) ka përmbushur të gjitha detyrimet fiskale;

Me respekt

Nënshkrimi i Personit të Autorizuar
Emri dhe Pozicioni i Nënshkruesit
Emri i Ofertuesit/Kryesuesit të Bashkimit të Përkohshëm
Adresa



Shtojca 11

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të projektit në lidhje me to:

Shtojca 12

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues*]

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: "Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe rehabilitim i rrugëve nacionale
....."

Afatet e ekzekutimit:



Shtojca 13

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues*]

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qellimi i projektit:

Bashkelidhur termat e references

Detyrat:

Shperndarja:

Vendi dhe dorezimi i projektit:

**Shtojca 14**

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën konkurruese të lartpërmendur. Procedura e kryer në përputhje me VKM 634 Datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ PPP të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale. ”.

Kërkesa/Propozimi/Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s'kualifikuat] [eliminuat, sepse Kërkesa/Propozimi/Oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [shënoni kutinë e duhur]:

[subjekti juaj]

- ☐ mori pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës, ose dosjen e procedurës konkurruese, ose pjesë të tij, që u përdorën nga autoriteti Kontraktues
- ☐ mori asistencë të paligjshme në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së procedurës konkurruese, ose një pjesë të saj

[subjekti juaj]

- ☐ Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikë korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal ose aktivitetet sipas ligjeve dhe rregullave të zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;
- ☐ Një gjykatë me juridiksion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;



- ☐ Është në ndjekje penale për një nga veprat penale;
- ☐ ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës;
- ☐ është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme;
- ☐ është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- ☐ nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- ☐ nuk ka përbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

Nuk arritët të paraqisni:

- ☐ Çertifikatat ose vërtetimet e kërkuara
- ☐ Një çertifikatë, dokument ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti Kontraktues me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj profesionale;
- ☐ Vërtetime të mjaftueshme, siç përshkruhen, që tregojnë se kandidati ose ofertuesi në fjalë i plotëson kërkesat për kapacitetet minimale financiare, teknike dhe profesionale, të specifikuara në dosjen e ofertës ose në njoftimin e kontratës;
- ☐ Autoriteti Kontraktues ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumenta që përmbajnë informacion të rremë, me qëllim kualifikimi;
- ☐ Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt] [është anomalisht e ulët];
- ☐ Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;
- ☐ (ndonjë shkak tjetër përveç atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

[Jeni s'kualifikuar] [oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Shënoni arsyet e hollësishme për s'kualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë]



Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktues ka shkelurosegjatë procedurës konkurruese, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të procedurës konkurruese.

Me respekt

< **Emri** >



Shtojca 15

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura konkuruese:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

2. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

Etj. _____ Vlera (me numra dhe fjale) _____

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. _____

2. _____

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues dhe referenca e kontaktit] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në DPK, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet” [data] [numri].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullari i Autoritetit Kontraktues]

**Shtojca 16****KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Shërbimet****Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për punët dhe ose shërbimet bazuar në VKM nr.634, datë 01.10.2014 “Rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”
- 1.2 Në çdo rast dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e koncesionit/partneritetit publik privat. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të kuadrit ligjor mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat janë (sipas VKM , nr.634, datë 01.10.2014) rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon procedurën konkurruese. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të VKM , nr.634, datë 01.10.2014 “Rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të kenë përparësi mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e procedurës konkurruese duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha anekset dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjerë që referohen në mënyrë indirekte.
- 2.2 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet dhe/ose Punët që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.3 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.4 “Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues” do të thotë personi apo një grup personash i emëruar nga Autoriteti Kontraktues që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktues.



- 2.5 “Autoritet Kontraktues” do të thotë Autoriteti Kontraktues qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktin shërbimet/punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në aktet ligjore në zbatim.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime dhe/ose Punët” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve dhe/ose Punëve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të nënshkruhet brenda afatit të shprehur në dokumentat e procedurës konkurruese.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të pavlefshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të jetë subjekt i kontrolluar apo të kontrollojë konsulentin ose apo ndonjë ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese për këtë koncesion/partneritet publik privat.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënKontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar që nënkontraktuesin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënKontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e kofidencës siç parashikohet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale



- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të garantojë Autoritetin Kontraktues për shkarkimin nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet quhen se janë prodhuar kur, nëpërmjet procesit të krjimit, përpunimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që furnizon me materiale.

Neni 8: Komunikimi

- 8.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 9 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe/ose Punët dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.



- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 10 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 10.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet dhe/ose Punët siç përcaktohet në Termat e References.
- 10.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha Shërbimet dhe/ose Punët, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 11 Specifikime dhe Skicime

- 11.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

Neni 12 Lejet dhe Liçensat

- 12.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë në fuqi gjatë gjithë kohezgjatjes së Kontratës së Koncesionit siguracionin për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen

**Neni 14: Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

14.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, organet shtetërore miratojnë akte normative të cilat kanë ndikim në datën e dorëzimit të shërbimeve të kontraktuara, në çmimin e kontratës, apo në mënyrën dhe kohën e përmbushjes së detyrimeve, këto kushte Kontraktuese do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është prekur në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të përcaktojë në kontratën e koncesionit rastet se kur ndryshimi i kuadrit ligjor kërkon rishikimin e kushteve të kontratës së koncesionit dhe rastet se kur ndryshimi i kuadrit ligjor kërkon rishikimin e kushteve të kontratës së koncesionit dhe rastet se kur ndryshimet ligjore sjellin efekt për palën Kontraktuese.

Neni 15: Forca Madhore

15.1 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të palëve Kontraktuese sic përcaktohet në praktikën më të mira të legjislacionit ndërkombëtar. Kontrata e Koncesionit duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar procedurat e njoftimit të ngjarjes së forces madhore nga pala e prekur, kohezgjatjen e saj, shkarkimin nga përgjegjësia kur është rasti, veprimet që propozohen për zbutjen e efekteve të forcës madhore.

Neni 16: Negociatat dhe Amendamentet

16.1 Kontratat e Koncesionit mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.

16.2 Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari /partneri privat.

16.3 Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;

b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;

c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor sic përcaktohet në Kontratën e Koncesionit;

ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.

16.4 Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

16.5 Pa shkelur dispozitat e VKM , nr.634, datë 01.10.2014 “Rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, termi “kushtet thelbësore” u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb



të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.

Neni 17: Zgjidhja për Shkak të Falimentimit ose Aftësisë Paguese

17.1 Në varësi të dispozitave të marrëveshjes direkte, Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

17.2 Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për zgjidhjen e Kontratës.

Neni 18: Zgjidhja për Shkak të Interesit Publik

18.1 Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

18.2 Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për zgjidhjen e Kontratës..

18.3 Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë detyrimet e e papaguar (përfshirë kryegjënë, interesin dhe tariffat) si dhe dëmin e shkaktuar (përfshirë fitimin e munguar) në masën e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit.

Neni 19: Nënkontraktimi

19.1 Koncesionari nuk do të hyjë në ndonjë nënkontratë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, përveç me nënkontraktuesët e pranuar, si pjesë e ofertës së koncesionarit. Autoriteti Kontraktues mund të mos japë, ose në rast se e ka dhënë atë, mund tërheqë pëlqimin për shkak të interesit publik ose në rast se nën-kontraktuesi i propozuar nuk gëzon kapacitetet e nevojshme për t'i mundësuar zbatimin e detyrimeve sipas nën kontratës së propozuar.

19.2 Në rast se koncesionari përfundon ndonjë nën-kontratë dhe propozon për të hyrë në një nën-kontratë zëvendësuese, duhet t'i paraqesë paraprakisht për miratim Autoritetit Kontraktues draftin e kontratës (dhe çdo ndryshim të saj) mes koncesionarit dhe nën-kontraktuesit zëvendësues. Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë të drejtë të refuzojë dhënien e pëlqimit për projekt kontratën përveç rasteve kur kushtet e draft nën-kontratës janë dukshëm të ndryshme nga kushtet e nënkontratës së parë, si dhe kur nën-kontraktuesi i propozuar nuk gëzon gjendjen e nevojshme financiare, teknike dhe ligjore për të mundësuar përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nën-kontratë.

19.3 Koncesionari do të jetë gjithnjë përgjegjës përkundrejt Autoriteti Kontraktues për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës së Koncesionit, pavarësisht nga fakti që një pjesë e shërbimeve dhe/ose punëve janë nënkontraktuar te palët e treta.

19.4 Dokumente e Procedurës Konkurruese mund të përmbajnë masën e nën-kontraktimeve që i lejohet Koncesionarit për të kontraktuar më palë të treta sipas rastit.

**Neni 20: Transferimi i të Drejtave**

20.1 Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e procedurës konkurruese, në bazë të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveç se nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari /partneri privat i mëparshëm.

20.2 Transferimi i kontratës së koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

20.3 Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues, përveç se nëse ky është rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit apo transferim nga aksionari në një filial të tij.

Neni 21: Sigurimi i Kontratës

21.1 Brenda _____ ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues sigurimin e kontratës në vlerën dhe formën siç parashikohet në kontratë. Deshtimi për të dorëzuar sigurimin e kontratës në formën dhe në vlerën e kërkuar brenda _____ ditëve do të shkaktojë moshyrjen në fuqi të kontratës dhe dhe sekuestrimin e vlerës së sigurimit të ofertës nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Neni 22: Baza Ligjore

22.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 23: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

23.1 Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes me mirëkuptim, ajo do të referohet për zgjidhje forumit sipas përcaktimeve të bëra në Kontratën e Koncesionit.

Neni 24: Përfaqësimi i Palëve

24.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.



24.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

24.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 25: Lajmërimet

25.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

25.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 26: Llogaritja e Afateve

26.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Shtojca 17**

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues]

**KUSHTET E VEÇANTA
Shërbimet**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktues është _____

1.2 Kontraktuesi është _____

Neni 2: Sigurimi i Kontratës

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën _____ duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, Kontraktuesit sipas skedarit të mëposhtëm: _____

Neni 3: Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues

3.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Data e Fillimit

5.1 Kjo kontratë: _____

Neni 6: Lloji i Kontratës

**Shtojca 18**

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktues]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR**Seksioni I Autoriteti Kontraktues****I.1 Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues**

Emri
Adresa
Tel/Fax
E-mail
Adresa e Internetit

I.1

I.3 Lloji i autoritetit Kontraktues:

Institucion qendror

**Seksioni II Objekti i kontratës****II.1 Lloji i Kontratës**

Koncesion / PPP

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Forma e Kontratës:
2. Objekti i kontratës:

II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në ☐ ☐ ☐ ☐



ose

duke filluar nga // me përfundim në /

II.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:

II.5 Ndarja në LOTE:

Po ☐ Jo ☐

Nese po

II.6 Përshkrim i shkurtër i loteve

1. _____

2. _____

3. _____

Etj.

Seksioni III Procedura

III.1 Lloji i procedurës:

Procedurë konkurruese e hapur ☐ e kufizuar ☐

III.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta më e mirë bazuar në:

Formulën e përcaktuar në shtojcën.....

Informacione të mëtejshme në DPK.

III.3 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të rregullta:



III.4. Gjate procedurws konkurruese jane perdorur janw pwrdorur dokumentet standard tw pregatitura nga Agjencia Kombetare e Prokurimit Publik.

Po ☐ Jo ☐

Seksioni IV Informacion shitesw mbi kontratën

IV.1 Numri i Kontratës: _____ Data e Kontratës
□□/□□/□□□□

IV.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa e Internetit _____

IV.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet dhe opsionet):

Vlera _____ (pa TVSH) Monedha _____
Vlera _____ (me TVSH) Monedha _____

IV.4 Informacione shitesë

Faqe zyrtare e Autoritetit Kontraktues, ose dokumentet e procedurws konkurruese mund te shkarkohen falas ne websitin zyrtar te Agjencise se Prokurimit Publik: <https://www.app.gov.al>

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi

Shtojca 19

[Letër me logo të Bankës]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data _____]

Për : [Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktues]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e koncesionit/PPP: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke qenë se:

- (emri i Ofertuesit Fitues) është shpallur fitues në Procedurën Konkurruese për Marrjen me Koncesion/PPP të _____, me vendndodhje në _____, sipas shkresës së (emri i Autoritetit Kontraktues) (me poshtë referuar si "Autoriteti Kontraktues"), Nr. ____ Prot, datë ____ 201 "Njoftimi i Fituesit"; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur pranë nesh Draftin e Kontratës ndërmjet tij dhe Autoritetit Kontraktues, "Për marrjen me koncesion/PPP të _____; dhe
- në Kontratën tuaj kërkohet lëshimi i një Sigurimi Kontrate në vlerën e specifikuar si më poshtë, si garanci për përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit të parashikuara në Kontratë; dhe
- (emri i Bankës) është dakord të lëshojë këtë garanci.

Deklarojmë se:

- Jemi garantuesit e kontratës Pwr dhewmien me koncesion/PPP të _____ deri në shumën totale prej (shuma në shifër dhe fjalë), shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë; dhe
- marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qene nevoja të bëni argumentim të kërkesës, cdo shumë brenda kufirit prej (shuma e garancisë); dhe
- për marrjen e kësaj garancie, nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë Koncesionarit\ Partnerit Publik Privat për te realizuar pagesën sipas kërkesës tuaj; dhe
- asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të Kontratës, për të cilën ju mund të bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kësaj Garancie.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përfshinë _____ ditë nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës]



Shtojca 20

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTUES

Ankesë drejtuar : *Autoriteti Kontraktues* ☐

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërisht).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

—

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

**1. Numër Identifikimi**

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e procedurës konkurruese, duke përfshirë **llojin e procedurës së përdorur** për koncesionin/ppp në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar

2. Autoriteti Kontraktues

Emri i autoritetit Kontraktues që administron procedurën konkurruese.

3. Vlera e Përlogaritur e Koncesionit/PPP

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/ shërbimeve që blihen.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**1. Baza Ligjore e Ankesës**

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave e procedurës konkurruese, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e procedurës konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave perkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionin/ ppp, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit Kontraktues**

4.Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

Po ☐ Jo ☐

-
2. Autoriteti Kontraktues Pranë të cilit është bërë Kundërshtimi

Emri i autoritetit kontraktues.

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

-
3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese



Çfarë mase korrigjuese kërkon?

4. Lista

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e procedurës konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Autoriteti përkatës** sipas VKM Nr.634, datë 01.10.2014 "Rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale"

Nr. Faks: E-

mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e Ankuesit

**VENDIM****Nr. 926, datë 29.12.2014****PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË
PRONËS SHTETËRORE, QË
PRIVATIZOHET APO
TRANSFORMOHET, DHE
PROCEDURËN E SHITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kriterëve të vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes, si më poshtë vijon:

I. PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË PASURISË SHTETËRORE

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros së ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe institucioneve me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i ministrit përgjegjës për ekonominë, për fillimin e procedurave të privatizimit apo të transformimit në shoqëri tregtare.

2. Institucionet qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore dërgojnë kërkesën e tyre për privatizimin e ndërmarrjeve apo institucioneve që kanë në varësi administrative ose në pronësi, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, sipas kërkesës së përmendur më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të qeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pasuritë e ndërmarrjeve apo institucioneve që kanë në varësi administrative, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e

këtyre pasurive. Në rast se ky afat tejkalohet, atëherë ministria përgjegjëse për ekonominë ngre një komision, të përbërë nga 3 (tre) anëtarë, i cili verifikon faktikisht objektin. Nëse pas këtij verifikimi rezulton se objekti është i braktisur dhe nuk përdoret nga institucioni që e ka në administrim apo në pronësi, atëherë ministri përgjegjës për ekonominë jep miratimin për privatizimin e objektit, duke konsideruar të dhënë pëlqimin nga institucioni administruar, dhe i kërkon atij caktimin e një përfaqësuesi në komisionin e vlerësimit të pronës.

Nëse institucionet qendrore dhe/apo organet e njësive të qeverisjes vendore shprehen për mosprivatizimin e pasurive të ndërmarrjeve, apo institucioneve që kanë në varësi administrative, atëherë ato duhet ta argumentojnë qartë këtë fakt.

Në rastet kur për objektet që janë në pronësi të organeve të pushtetit vendor është marrë vendimi i këshillit të njësive të qeverisjes vendore për privatizimin/tjetërsimin e tyre dhe këto objekte janë miratuar për t’u përfshirë në procedurë privatizimi, por organi i pushtetit vendor përkatës nuk dërgon përfaqësuesin e tij si anëtar të komisionit të vlerësimit, institucioni përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore i kërkon institucionit të prefektit përkatës të dërgojë përfaqësuesin që do të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit.

Përfaqësuesi i prefekturës do të kryejë të gjitha procedurat për privatizimin e objektit, bashkë me truallin, sipas këtij vendimi.

3. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi, ngrihet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ky komision ka në përbërje të tij 3 (tre) anëtarë: kryetarin e degës së shoqërive publike, në prefekturën ku ndodhet objekti, një ekspert vlerësues të licencuar dhe një përfaqësues të ndërmarrjes apo institucionit në administrim të të cilit ndodhet objekti. Komisioni kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike.

Sipas nevojave të procesit të vlerësimit të objektit, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron që në komisionin e vlerësimit të marrë pjesë edhe një ekspert kontabël apo ekspertë të tjerë të fushës përkatëse.

4. Ekspertët vlerësues, në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës shtetërore



përzgjidhen nga ministri përgjegjës për ekonominë. Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.) përballohen nga ministria përgjegjëse për ekonominë, përveç rasteve kur ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron pagesën nga institucione, ndërmarrje dhe/ose shoqëri të varësisë. Kjo pagesë do të jetë 2 (dy) për qind e vlerës së objektit apo të grupobjekteve të vlerësuar, por jo më pak se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë, me TVSH.

5. Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si element i veçantë, bëhet nga institucioni përkatës i varësisë administrative. Pas nxjerrjes së miratimit për privatizim, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit të pasurisë.

Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës administrative dhe në përbërje të tij ka 3 (tre) anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë ekspert vlerësues i fushës përkatëse. Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.), në këtë rast, mbulohen nga institucioni ose ndërmarrja në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

6. Ngritja e komisionit të vlerësimit për objekte ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti që nuk ekziston më bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë. Komisioni i vlerësimit, në këtë rast, kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën ku ndodhet objekti dhe përbëhet nga ekspertë vlerësues të licencuar, sipas nevojave të procesit të vlerësimit.

II. VLERËSIMI I ELEMENTEVE TË PASURISË SHTETËRORE

1. Procedurat për vlerësimin e pasurisë shtetërore fillojnë me daljen e urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Vlerësimi i objekteve bëhet nga komisioni i vlerësimit, në përputhje me vlerën reale të tregut, duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi për vlerësimin e kryer dhe për dokumentet e hartuara e të nënshkruara prej tij (genplane, situacione, aktvlerësime etj.).

3. Me daljen e urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të objektit që do të privatizohet apo që

do të përfshihet në fondin e kompensimit, komisioni i vlerësimit inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit dhe, më pas, ekspertët vlerësues të këtij komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përgatitin në 5 (pesë) kopje origjinale genplanin e ndërmarrjes apo të objekteve që do të privatizohen, ku përcaktohen qartë sipërfaqet nën objekt dhe truall funksional. Dega e shoqërive publike përkatëse vendos një njoftim në objekt si dhe në mjediset e organit të qeverisjes vendore në territorin e të cilit ndodhet objekti, për efekt të ish-pronarëve të truallit, nëse ka.

4. Eksperti vlerësues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e urdhrit për privatizimin e objektit, përgatit në 5 (pesë) kopje origjinale genplanin përkatës, ku përcaktohen qartë sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe ajo e përgjithshme. Eksperti vlerësues mban përgjegjësi për hartimin e saktë të këtij genplani.

5. Komisioni i vlerësimit, pas marrjes së genplanit të përgatitur nga ekspertët, i drejton institucionit të prefektit, në territorin e të cilit ndodhet objekti, kërkesën për konfirmimin e këtij genplani.

Prefekti autorizon një përfaqësues, i cili nënshkruan genplanet e objekteve të kërkuara nga dega e shoqërive publike. Institucioni i prefektit konfirmon genplanin e objektit, duke nënshkruar dhe vulosur në 5 (pesë) kopje origjinale, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës së degës së shoqërive publike përkatëse, dhe i përcjell kësaj dege dokumentacionin, të nënshkruar e të vulosur. Tejkalimi i këtij afati ngarkon me përgjegjësi këtë institucion.

7. Pas marrjes së genplanit të objektit, të konfirmuar nga prefektura, dega e shoqërive publike i kërkon zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të dhëna për pronësinë e objektit dhe truallit që privatizohet, hartën treguese, vërtetimin hipotekor apo certifikatën e pronësisë, nëse ka. Kërkesën e mësipërme dega e shoqërive publike shoqëron me një kopje të genplanit, të konfirmuar nga prefektura e qarkut përkatës. Zyra vendore regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i dërgon degës së shoqërive publike të dhënat që disponon për pronën që



privatizohet, hartën treguese, vërtetimin hipotekor apo certifikatën e pronësisë, nëse ka të tillë. Zyra vendore regjistrimit të pasurive të paluajtshme mban përgjegjësi ligjore për të dhënat e konfirmuara si dhe për tejkalimin e afatit ligjor, të përcaktuar në këtë vendim.

8. Dega e shoqërive publike, pas marrjes nga zyra vendore regjistrimit të pasurive të paluajtshme të hartës treguese, me të dhënat përkatëse të objektit, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin nëse trullit ku ndodhet objekti ka pronarë, të njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe çmimin përkatës të trullit ku ndodhet objekti, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve nga kjo agjenci, dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, atëherë ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së trullit të objektit që do të privatizohet.

9. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i dërgon degës së shoqërive publike konfirmimin për çmimin e trullit të objektit si dhe vendimet përkatëse të kthimit dhe kompensimit të pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku të jetë përcaktuar qartë kufiri i pronës si dhe çdo informacion shtesë, nëse ka, që lidhet me vendimin përkatës të kthimit dhe kompensimit të pronave.

10. Eksperti vlerësues përcakton çmimin e trullit ku ndodhet objekti përkatës, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve, të hartuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, atëherë ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së trullit të objektit që do të privatizohet sipas çmimit të tregut. Eksperti vlerësues mban përgjegjësi për vlerësimin e trullit të bërë prej tij. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave mban përgjegjësi për çmimin e trullit, të konfirmuar me shkresën përkatëse si dhe për tejkalimin e afatit ligjor, të përcaktuar në këtë vendim.

Kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzon ekspertit vlerësues gjithë dokumentacionin e mësipërm dhe eksperti vlerësues harton raportin

e vlerësimit për objektin përkatës. Eksperti vlerësues zgjedh metodën përkatëse të vlerësimit të objektit dhe mban përgjegjësi për vlerësimin e bërë dhe vlerën e përcaktuar prej tij.

11. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat, ndërtimet dhe linjat e prodhimit/shërbimit duhet të jetë jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë, nga data e daljes së urdhrit për ngritjen e komisionit të vlerësimit nga titullari. Për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj. ky afat duhet të jetë jo më shumë se 20 (njëzet) ditë, nga data e daljes së urdhrit. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi për respektimin e këtij afati.

12. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit i dërgohet:

a) ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit/shërbimit, me shkresë përcjellëse, të nënshkruar e të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt dhe ajo funksionale. Ministria përgjegjëse për ekonominë, pasi kontrollon nëse ky dokumentacion ka kaluar në strukturat përkatëse, ia përcjell atë Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave.

b) Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj., me shkresë përcjellëse, të nënshkruar dhe të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, kur asetet do të shiten të veçanta.

13. Vlerësimi i pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që transformohen, në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

14. Eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme harton genplanin përkatës të shoqërive aksionare dhe të shoqërive me kapital të përbashkët, të cilat janë në proces vlerësimi për privatizim, kur del i nevojshëm hartimi i një genplani të ri, të ndryshëm nga ai i përgatitur në çastin e themelimit të shoqërisë.

15. Shoqëria, kërkesën për konfirmimin e genplanit, të hartuar nga eksperti vlerësues përkatës, ia dërgon institucionit të prefektit, ku ajo ka vendndodhjen. Institucioni i prefektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së



kërkesës, konfirmon genplanin e shoqërisë, duke nënshkruar dhe vulosur atë në 5 (pesë) kopje origjinale, dhe më pas ia përcjell shoqërisë.

16. Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen mbyllen në çastin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen e debi-kredive, nga data e shpalljes së ndryshimit të pronës shtetërore.

17. Për detyrimet debitore dhe kreditore veprohet, si më poshtë vijon:

a) Kur bëhet privatizimi i të gjithë ndërmarrjes shtetërore detyrimet debitore dhe kreditore i kalojnë shtetit. Institucioni qendror ose organet e pushtetit vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar ose një profesionist të lirë me një kontratë të posaçme, për ndjekjen e arkëtimit, deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit të objektit. Këta punonjës kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) paga bazë të përgjegjësit të financës në këshillin e qarkut ose këshillin bashkiak. Ky shpërblim reduktohet deri në zero nëse nuk zbatohet kontrata. Kjo kontratë duhet të jetë e vlefshme deri në 3 (tre) muaj dhe, pas kësaj kohe, veprohet në bazë të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

b) Kur bëhet privatizim i pjesshëm i ndërmarrjes shtetërore detyrimet debitore dhe kreditore të saj i kalojnë, për ndjekje, administratës që mbetet për pjesën shtetërore.

18. Në rastet kur në përbërje të pronës që privatizohet nuk ka objekte ndërtimore sipërfaqësore, por vetëm objekte ndërtimore nëntokësore, atëherë privatizimi do të bëhet vetëm për objektin (strukturën ndërtimore) dhe sipërfaqen e zënë prej tij, sipas inventarit të miratuar me aktin ligjor përkatës të institucionit administrues/pronar. Në rastet kur për truallin ku ndodhet objekti nëntokësor në proces privatizimi ka pronarë truall, të njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, atëherë ata gëzojnë të drejtën e parablerjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

III. PROCEDURA E SHITJES SË PRONËS SHTETËRORE

1. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, e pranon dosjen e

vlerësimit për objektin që do të privatizohet, nëse për këtë objekt ka dokumentacion të rregullt, i cili u ka kaluar strukturave përkatëse, të përcaktuara në këtë vendim. Në rast të kundërt, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kërkon plotësimin e dokumentacionit.

2. Shitja e objektit bëhet si më poshtë vijon:

a) Për rastet kur konfirmohet se objekti ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, shitja bëhet pa ankand dhe subjektet e shpronësuara të truallit, në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare.

Në këtë rast, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, afishon një njoftim në mjediset e saj, për një afat njëzetditor, vetëm për pronarët e truallit, ndërsa dega e shoqërive publike afishon këtë njoftim në mjediset e veta dhe në objekt.

Dokumentacioni për dhënien e së drejtës së parablerjes, për objektin që privatizohet, në çdo rast, shqyrtohet e konfirmohet me procesverbal të veçantë dhe miratohet nga komisioni i ngritur nga drejtori i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave.

b) Për rastet kur komisioni i ngritur nga drejtori i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, ka vështirësi në përditësimin e dokumentacionit hartografik (planvendosja e pronës së ish-pronarëve, genplani i objektit në proces privatizimi dhe harta treguese lëshuar nga zyra vendore përkatëse regjistrimit të pasurive të paluajtshme) për truallin, sipërfaqen nën objekt dhe sipërfaqen funksionale të objektit, apo ndërmarrjes në proces privatizimi, sipas pikës 12, të këtij kreu, atëherë Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, do të angazhojë ekspertë të licencuar të fushës së hartografisë. Në përfundim të verifikimit, ekspert i licencuar do të dorëzojë dokumentacionin hartografik, me shënimet përkatëse, për rezultatin e verifikimit. Eksperti mban përgjegjësi ligjore për përfundimet që do të paraqesë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave. Shpenzimet për kryerjen e këtyre verifikimeve do të mbulohen nga vetë pala e



interesuar për blerjen e objektit apo ndërmarrjes.

c) Në rastet kur ish-pronarët e truallit, pas afishimit të njoftimit, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe degët e shoqërive publike në prefekturën përkatëse, nuk kanë paraqitur dokumentacionin, sipas pikës 11, të këtij kreu, bëhet një njoftim, nga një herë në dy gazeta me qarkullim kombëtar, duke i përcaktuar ish-pronarit të truallit një afat të ri tridhjetëditor për dorëzimin e dokumentacionit ligjor. Nëse edhe në këtë afat të dytë ish-pronari nuk paraqitet, atëherë objekti kalon në publikim për shitje me ankand, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Në rast të realizimit të shitjes së objektit, bashkë me truallin, me ankand, vlera e truallit, e përcaktuar sipas hartës së vlerës, i shkon drejtpërdrejt ish-pronarit të truallit.

ç) Në rastet kur konfirmohet se objekti që privatizohet nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, si dhe për rastet kur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk është në gjendje të konfirmojë pronësinë e truallit, për objektin që privatizohet, ai i nënshtrohet ankandit, sipas procedurave të këtij vendimi. Kur, në datën e zhvillimit të ankandit, paraqitet ish-pronari i truallit, me dokumentacionin sipas pikës 11, të kreut III, të këtij vendimi, atëherë ky e gëzon të drejtën e parablerjes me vlerën fillestare të objektit. Edhe në këtë rast do të veprohet sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, por vetëm pasi të jetë konfirmuar dokumentacioni i pronësisë, i depozituar nga ish-pronari i truallit pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, organeve të pushtetit vendor, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo çdo institucioni tjetër shtetëror.

Në rastet kur, gjatë periudhës së publikimit të objektit, para datës së zhvillimit të ankandit, depozitohet në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kërkesa e ish-pronarit të truallit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së truallit, atëherë do të veprohet sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, por vetëm pasi të jetë konfirmuar dokumentacioni i pronësisë, i depozituar nga ish-pronari i truallit, pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të

Pronave, organeve të pushtetit vendor, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo çdo institucioni tjetër shtetëror.

3. Në ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive në likuidim e sipër, të cilat janë të përfshira në kapitalin e tyre, nuk zbatohet e drejta e parablerjes për ish-pronarët e truallit. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e vlerësuar me çmimet e hartës së vlerës së truallit, miratuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Procedurat e publikimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentet e vlerësimit të objektit.

5. Vlera e fillimit të ankandit është VAM-i (vlera e amortizimit të mbetur), i përcaktuar sipas kreut II, të këtij vendimi, (mjete kryesore + mjete xhiroje + vlera e truallit). Ankandi zhvillohet vetëm për vlerën e mjeteve kryesore + vlerën e truallit, ndërsa vlera e mjeteve të xhiros i shtohet vlerës së arritur në ankand. Shitja e pasurisë së luajtshme bëhet vetëm me ankand, sipas procedurave të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, pasi ka pranuar dokumentacionin për shitjen e objektit, ndërmerr hapat përkatës për publikimin e privatizimit të tij, si më poshtë vijon:

a) Periudha e botimit zgjat 21 (njëzet e një) ditë, nga data e botimit të parë, dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Dita e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin që Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dërgon për botim. Brenda këtij afati, ky njoftim botohet një herë edhe në një gazetë me qarkullim kombëtar.

b) Boton listën e objekteve që do të privatizohen dhe shpall atë në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, me të dhënat për çdo objekt.

c) Afishon, fillimisht, njoftimin për zhvillimin e ankandit në mjediset e saj, ndërsa dega e shoqërive publike, në prefekturë, e afishon njoftimin në mjediset e veta, në ndërmarrjen në administrim të së cilës është objekti, në objekt si



dhe në mjediset e organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet objekti që privatizohet, sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike. Dega e shoqërive publike, në prefekturë, dërgon, zyrtarisht, procesverbalin për vendosjen e afisheve, brenda afatit të botimit, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave.

7. Njoftimi për botim përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- b) Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që privatizohet;
- c) Vlerën fillestare të ankandit;
- ç) Sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt;
- d) Emrin dhe mbiemrin e pronarit të truallit, nëse ka etj.

8. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në Ministrinë e Financave, për Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë drejtori, si dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

9. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, harton dhe arkivon një procesverbal, i cili përmban:

- a) kopjen e buletinit;
- b) kopjen e afishimit në gazetë;
- c) datat e botimit të njoftimeve;
- ç) kopjen e njoftimit me afishe.

10. Pjesëmarrësit në ankand duhet t'i paraqesin komisionit të ankandit, në vendin, datën dhe orën e njoftuar, këto dokumente:

a) kërkesën me shkrim për blerjen e objektit të regjistruar në protokollin e Ministrisë së Financave;

b) mandatpagesën, apo garancinë bankare, që vërteton derdhjen, apo ngurtësimin e 20 (njëzet) për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave.

11. Ish-pronari i truallit, për blerjen e ndërmarrjes ose të objektit që shtrihet mbi të, duhet të paraqesë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë me shkrim për blerjen e objektit, të regjistruar në protokollin e Ministrisë së Financave;

b) mandatpagesën apo garancinë bankare, që vërteton derdhjen, ose ngurtësimin e 20 (njëzet) për qind të vlerës fillestare të ankandit, në lekë, vetëm për objektin, për llogari të Ministrisë së Financave, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht, brenda afatit të pranimit të kërkesave;

c) vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekti pronar i tokës;

ç) dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla;

d) deklaratën noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar, ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim gjyqate të formës së prerë.

12. Kur sipërfaqja e tokës e njohur apo e kthyer ish-pronarit të truallit, shtrihet në mbi 70 (shtatëdhjetë) për qind të sipërfaqes së truallit nën objektin që privatizohet, e drejta e parablerjes shtrihet në të gjithë objektin, nëse pjesa tjetër nuk ka pronarë. Në të kundërt, pavarësisht se njëri nga ish-pronarët apo bashkëpronarët e plotëson kushtin e përcaktuar në paragrafin e parë, të kësaj pike, dhe pjesa tjetër ka pronarë truall të identifikuar, objekti privatizohet në bashkëpronësi, me marrëveshje të dokumentuar.

Nëse nuk arrihet marrëveshje dokumentuar ndërmjet bashkëpronarëve, objekti u nënshtrohet procedurave të ankandit dhe ish-pronarët kompensohen financiarisht, sipas vlerës së truallit, të vlerësuar sipas hartës së vlerës.

Në rastet e shpalljes fitues të ankandit që zhvillohet për shitjen e objektit të njërit prej ish-pronarëve të truallit (trashëgimtarëve të tij), në pagesën e vlerës së fitimit të ankandit zbritet vlera e truallit që i përket pjesës së tij, e njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe



Kompensimit të Pronave, e vlerësuar me çmimet e hartës së vlerës së truallit. Në këtë rast, për përcaktimin e sipërfaqes së truallit për pronarin do të veprohet sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij kreu.

Në rastet kur për objektin që privatizohet ka një pronar apo disa bashkëpronarë, të cilët kanë një marrëveshje të dokumentuar dhe gëzojnë të drejtën e parablerjes, por një pjesë e truallit, sipas genplanit të privatizimit, nuk bie në pronën e ish-pronarëve të konfirmuar shtetërorë, veprohet, si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, ua ofron për blerje bashkëpronarëve që gëzojnë të drejtën e parablerjes së objekteve. Në rast se ish-pronarët shprehen me shkrim se nuk janë dakord ta blejnë këtë sipërfaqe trualli, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, i dërgon një shkresë, të shoqëruar me kopje të genplanit, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për përdorimin e kësaj sipërfaqeje për fond kompensimi për ish-pronarët, duke vënë në dijeni edhe ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

13. Në rastet kur objektit i është ulur vlera e fillimit të ankandit, ish-pronari i truallit, për të ushtruar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë, sipas vlerës fillestare dhe jo sipas vlerës së ulur.

14. Kur për objektet e shpallura për shitje me VAM fillestar, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerje, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, cakton një VAM tjetër, më të ulët se VAM-i fillestar, për privatizimin e objektit, duke filluar procedurat e publikimit, sipas pikës 6, të këtij kreu.

15. Ulja e VAM-it të objekteve bëhet sipas këtij kategorizimi:

a) për ndërmarrjet ose objektet, deri në 30 (tridhjetë) për qind;

b) për makineritë, pajisjet, inventarin ekonomik, mjetet e transportit, mjetet e xhiros, deri 50 (pesëdhjetë) për qind. Në këto raste, objekti u nënshtrohet edhe një herë të gjitha procedurave të shitjes, të parashikuara në këtë vendim.

16. Në rastet kur mbetet vetëm një blerës, si në publikimin me vlerë fillestare, ashtu edhe në

rastin kur objekti është i publikuar me ulje VAM-i, vendoset një njoftim, me afishe, pranë mjediseve ku do të kryhen procedurat e zhvillimit të ankandit, për një periudhë dhjetëditore, dhe brenda këtij afati bëhet një njoftim, vetëm 1 (një) herë në një gazetë me qarkullim kombëtar. Pas këtij publikimi, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, realizon shitjen e objektit blerësit të vetëm, nëse nuk ka kërkesa të tjera për blerje pas këtij publikimi.

17. Procedurat, për rastet e parashikuara në pikat 2, 6, 12 e 16, të këtij vendimi, fillojnë me miratimin e drejtorit të Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave. Çdo element shtesë është pjesë e botimit.

18. Për rastet kur nuk është realizuar shitja, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Për objektet ndërtimore, të cilat kanë kaluar të gjitha fazat e shitjes dhe nuk janë shitur, dokumentacioni i vlerësimit të objektit kthehet nga Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, pas 8 (tetë) muajve nga zhvillimi i fazës së fundit të shitjes. Në rast se gjatë kësaj periudhe ka kërkesa me shkrim për blerje të objektit, atëherë përsëritet procedura e fazës së fundit të shitjes. Ministria përgjegjëse për ekonominë e dërgon dokumentacionin e kthyer në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t'u përdorur si fond i kompensimit fizik.

Në rast se për objektin, dokumentacioni i të cilit është kthyer për t'u përdorur si fond kompensimi fizik, ka kërkesa me shkrim nga ish-pronarët e truallit, ministria përgjegjëse për ekonominë i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kthimin e dokumentacionit të vlerësimit, pasi kjo e fundit të ketë bërë verifikimin e vlefshmërisë së vendimit që njeh pronësinë.

b) Makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventari ekonomik etj., të cilat nuk janë shitur, pasi janë zbatuar fazat e shitjes, sipas VAM-it fillestar dhe VAM-it të ulur, kthehen nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, në degën e shoqërive publike përkatëse, për të cilat veprohet sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për



menaxhimin e aktiveve të njësive të sektorit publik”, në zbatim të tij.

19. Komisioni i ankandit kryesohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- përfaqësuesin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë;

- përfaqësuesin e organit që ka në pronësi, ruajtje, apo në varësi administrative objektin.

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

Në rast se në ditën e njoftuar për zhvillimin e ankandit nuk paraqitet njëri nga anëtarët e komisionit, anëtari tjetër i pranishëm i komisionit administron kërkesat e paraqitura për blerje dhe komisioni njofton një ditë tjetër për zhvillimin e ankandit, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e parë e njoftuar për ankand. Nëse edhe në njoftimin e dytë nuk paraqitet njëri nga anëtarët e komisionit të ankandit, atëherë Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, plotëson komisionin e ankandit me një anëtar, brenda strukturës së drejtorisë, dhe urdhëron zhvillimin e ankandit.

20. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- a) regjistron, vërteton dhe legjitimon pjesëmarrësit në ankand, në bazë të dokumentacionit të kërkuar (publikuar) paraprakisht;

- b) prezanton anëtarët e komisionit të ankandit;

- c) deklaron vlerën fillestare të ankandit;

- ç) deklaron hapin e dhënies të ofertave për vlerën fillestare, për pjesëmarrësit në ankand;

- d) drejton marrjen e ofertave;

- dh) siguron që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit;

- e) shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues të ankandit.

21. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

- a) regjistrimin e identitetit të pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së përfaqësimit;

- b) emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;

- c) deklarimin e vlerës fillestare të ankandit;

- ç) deklarimin e hapit të dhënies së ofertave për vlerën fillestare, për pjesëmarrësit në ankand;

- d) shpalljen e personit të fundit, i cili deklaron çmimin më të lartë, si fitues të ankandit.

Komisioni i ankandit duhet të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

22. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, u kthehet 20 (njëzet) për qind e vlerës fillestare, ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 (njëzet) për qind e vlerës fillestare, ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

23. Personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit, ose të drejtën e parablerjes, pajiset nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, me autorizim për kalim pronësie, ku përcaktohen qartë detyrimet e blerësit.

24. Blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, është i detyruar të bëjë pagesën, vetëm me lekë, për pjesën e mbetur, sipas çmimit të arritur në ankand, për objektin dhe truallin.

Ish-pronarët e truallit, të cilët janë shpallur fitues me të drejtën e parablerjes për objektin apo ndërmarrjen që privatizohet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e lëshimit të autorizimit për kalim pronësie, nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, janë të detyruar të bëjnë pagesën e vlerës së mbetur të objekteve dhe të mjeteve kryesore, me letra me vlerë dhe bono privatizimi.

25. Të ardhurat e realizuara nga shitja ndahen, si më poshtë vijon:

- a) Për shitjen e objektit (mjete kryesore, mjete xhiroje etj.):

- i) 5 (pesë) për qind e vlerës së shitjes i kalon Ministrisë së Financave;

- ii) 30 (tridhjetë) për qind e vlerës së shitjes i kalon ministrisë përgjegjëse për ekonominë;

- iii) 65 (gjashtëdhjetë e pesë) për qind e vlerës së shitjes i kalon buxhetit të shtetit.

- b) Për shitjen e truallit, 100 (njëqind) për qind e vlerës së shitjes kalon në buxhetin e shtetit, përveç rasteve kur është i identifikuar ish-pronari i truallit. Në këto raste do të veprohet sipas shkronjës “c”, pika 2, të kreut III, të këtij vendimi.



26. Nëse personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 (tridhjetë) ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, si fitues ankandi, ai humbet të drejtën e blerjes si dhe të marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Pagesa e ngurtësuar prej 20 (njëzet) për qindësh, për pjesëmarrje në ankand, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas këtij vendimi.

Nëse ish-pronari i truallit që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan pjesën e mbetur të çmimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, atëherë pagesa e ngurtësuar prej 20 (njëzet) për qindësh, për pjesëmarrje në blerje, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi.

27. Pas pagesës së vlerës së plotë të objektit (objekti bashkë me truallin për shitjet me ankand), Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe drejtori i ndërmarrjes (apo përfaqësues të autorizuar të tyre dhe të organit që e ka në pronësi, ruajtje, apo në varësi administrative objektin), janë të detyruar të nënshkruajnë kontratën e shitjes me blerësit privatë. Dorëzimi i objektit bëhet, në mënyrë të detyrueshme, nga drejtori i ndërmarrjes, përfaqësuesi i tij apo përfaqësuesi i organit që e ka në pronësi, ruajtje apo në varësi administrative objektin dhe nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, në prani të blerësit. Procesverbali i dorëzimit do të jetë pjesë përbërëse kontratës së shitjes.

28. Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite, me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit e parë të objektit apo ndërmarrjes, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht ndërmarrja nuk ekziston, bëhen nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësit, me kushtin që për këto objekte apo ndërmarrje të mos jenë bërë transkriptime me palë të treta pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme,

konfirmuar nga kjo e fundit, dhe kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie, është i rregullt.

Kur ndërmarrja ekziston, kontrata bëhet nga drejtori i ndërmarrjes dhe blerësi, para noterit.

Gjithashtu, Drejtoria e Drejtimit të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryen të njëjtën procedurë edhe për kontratat e shitjes së trojeve të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare Privatizimit dhe degët e saj në rrethe.

29. Në rastet kur nga ish-Agjencia Kombëtare Privatizimit dhe degët e saj në rrethe janë kryer të gjitha procedurat ligjore për privatizimin e objekteve apo të ndërmarrjeve shtetërore, sipas dokumentacionit të plotë që ndodhet në arkivin e Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike (dosja e vlerësimit, ankandi, apo e drejta e parablerjes, autorizimi për kalim pronësie, pagesa e plotë etj.), por që, për arsye të ndryshme, nuk ka qenë e mundur të lidhet kontrata e shitjes dhe kur, aktualisht, nuk ekziston ndërmarrja që e ka pasur në administrim objektin, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën përkatëse, dhe blerësi nënshkruajnë kontratën e shitjes, sipas legjislacionit në fuqi.

30. Nuk lejohen dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve që janë publikuar për shitje.

31. Për shitjet e bëra nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, njoftohet, me një evidencë statistikore, në datën 20, të çdo muaji, ministria përgjegjëse për ekonominë.

32. Pasuritë shtetërore, të dhëna me kontratë qiraje ose enfitëoze, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², i shiten, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kontraktuesit, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së truallit, si dhe kur subjekti nuk ka detyrime ndaj shtetit, sipas kontratës së qirasë. Me plotësimin e këtij kushti, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron vazhdimin e procedurave për privatizimin e objektit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në rastet kur objekti i marrë me qira apo enfitëozë është shembur plotësisht dhe mbi truallin e tij është ndërtuar një objekt krejtësisht i ri, apo në rastet kur objektit të marrë me



qira/enfiteozë i janë bërë ndryshime, shitesa apo prishje të shumta (të miratuara me aktet ligjore përkatëse), që e bëjnë të vështirë vlerësimin real të tij, pasi objekti është tjetërsuar, vlerësimi i objektit të marrë me qira/enfiteozë, si dhe genplani bëhen në bazë të dokumentacionit ekonomiko-teknik që disponon institucioni shtetëror që e ka në administrim objektin, në bazë të çdo dokumentacioni tjetër të mundshëm që mund t'i shërbejë këtij vlerësimi, si dhe në bazë të kontratës së qirasë/enfiteozës dhe dokumentacionit përkatës, bashkëlidhur saj (genplani, procesverbal i dorëzimit, fotografite e objektit në momentin e marrjes me qira etj.).

Për qiramarrësit që blejnë nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, objektin shtetëror (godinën + linja teknologjike, makineri e pajisje), të cilin e kanë pasur me qira, në rastet kur vlera e investimit është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së trullit, shlyerja e vlerës së objektit (godinës + linjës teknologjike, makineri e pajisje) bëhet deri në 80 (tetëdhjetë) për qind të vlerës së saj me bono privatizimi, apo me lekë privatizimi, sipas kërkesës me shkrim, të depozituar në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike) nga blerësi i objektit. Pagesa e vlerës së trullit, për pasuritë shtetërore të dhëna me qira/enfiteozë, do të bëhet vetëm me lekë.

Për rastet kur objekti ka ish-pronar truall, vlera e trullit, sipas përcaktimeve të bëra në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim.

33. Kur ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron përfshirjen në procedurë privatizimi të ndërmarrjes, shoqërisë dhe institucionit që ka dhënë mjedise me qira/enfiteozë, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², apo urdhëron përfshirjen në procedurë privatizimi të objektit të dhënë me qira, mbi 500 (pesëqind) m², përpara përfundimit të kontratës së qirasë, në publikimin për shitjen e tij njoftohet ekzistenca e kontratave të qirasë/enfiteozës të lidhura në këtë objekt.

Blerësi është i detyruar të respektojë kushtet e kontratës deri në përfundimin e afatit të saj.

IV. DETYRAT DHE TË DREJTAT PËR ZBATIMIN E KËTJ VENDORI

1. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, drejtori i ndërmarrjes apo përfaqësuesi i tij, dhe

përfaqësuesi i organit që e ka në pronësi, ruajtje, apo në varësi administrative objektin, janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit që privatizohet, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e dhënies së autorizimit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave.

2. Për diferencat fizike të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të objektit ose ndërmarrjes, mbahet një procesverbal, në prani të drejtorit të ndërmarrjes apo përfaqësuesit të tij dhe përfaqësuesit të organit që e ka në pronësi, ruajtje, apo në varësi administrative objektin, ku evidentohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit. Procesverbal i dorëzimit nënshkruhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, përfaqësuesi i institucionit që ka në administrim objektin dhe fituesi i së drejtës së blerjes së tij. Ky procesverbal shërben si aktedorëzimi i pasurisë.

3. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, njofton institucionin përkatës administrues për diferencat e rezultuara, sipas procesverbalit të dorëzimit, duke kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë, zhdëmtimin e tyre dhe, kur është e nevojshme, ndjekjen penale.

4. Shitja e trullit është pjesë e kontratës së shitjes së ndërmarrjes ose objektit dhe pagesa e çmimit të trullit bëhet vetëm me lekë.

5. Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objektit, me autorizimin e drejtorit të Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, zgjatet afati 45 (dyzet e pesë) - ditë të dorëzimit. Në rastet kur për blerjen e objektit janë shpallur fitues bashkëpronarë, me të drejtën e parablerjes apo të ankandit dhe, në çastin e nënshkrimit të kontratës, njëri nga bashkëpronarët refuzon nënshkrimin e kontratës së shitjes, atëherë zbatohen dispozitat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

6. Procesverbal i nënshkruar dorëzohet në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave ia kthen vlerën e munguar blerësit, duke u bazuar në diferencat e përligjura, të evidentuara me procesverbalet përkatëse. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, drejtori i ndërmarrjes apo



përfaqësuesi i tij, përfaqësuesi i organit që ka në pronësi, ruajtje apo varësi administrative objektin që privatizohet, kanë të drejtë të marrin ekspertë për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësinë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit, çdo blerës ka të drejtë të marrë pjesë ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

7. Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore nëpërmjet ankandit dhe kur ka diferenca në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave është vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit, në krahasim me vlerën fillestare të ankandit për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë me urdhër të ministrit të Financave.

8. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, realizon edhe privatizimin (shitjen) e aseteve financiare jofinanciare të shoqërive huamarrëse, sipas kreut III, të këtij vendimi.

Shoqëritë huamarrëse dërgojnë dokumentacionin e vlerësimit të aseteve në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, të Ministrisë së Financave.

9. Për kontratat e shitjes të deklaruara të pavlefshme me vendim gjykatë të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, ia kthen dosjen e vlerësimit të objektit ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për fillimin e rivlerësimit të objektit, në zbatim të këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi për privatizimin.

10. Procedurat e privatizimit të objekteve apo ndërmarrjeve, të filluara nga ish-Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe që ndodhen në fazën e pagesës së vlerës prej 20 (njëzet) për qind, për pjesëmarrje në blerje, si dhe të pagesës prej 80 (tetëdhjetë) për qind të vlerës së mbetur të çmimit të objektit, apo të çmimit të ankandit, si dhe objekteve për të cilat ka përfunduar pagesa e plotë e çmimit të objektit, apo çmimit të ankandit, do të përfundohen sipas këtij vendimi.

11. Në zbatim të këtij vendimi përfshihen procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve që ndodhen në ministrinë përgjegjëse

për ekonominë dhe në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

12. Ky vendim nuk do të zbatohet për procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve për të cilat komisionet e vlerësimit kanë kërkuar konfirmimet përkatëse pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, apo pranë prefektit të qarkut, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

13. Për praktikat të cilat ndodhen në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, në zbatim të vendimeve të mëparshme, që janë në proces dhe ndodhen në fazën kur ka përfunduar procedura e publikimit para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe praktikat për të cilat ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të shitjes së tyre, për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave të hartojnë udhëzimet përkatëse, në zbatim të pikave 1 dhe 2, të kreut I, pikave 3, 4, 5, 8 e 12, të kreut II, dhe pikave 2, 4, 6, 10, 20, 24, 32 e 33, të kreut III, të këtij vendimi.

15. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 9.6.2010, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, nr. 804, datë 22.7.2009, “Për përcaktimin e çmimit të trojeve, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje”, si dhe udhëzimet e dala në zbatim të tyre, shfuqizohen.

16. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefekti i qarkut, organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 930, datë 29.12.2014****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË BURIMEVE NATYRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 5 e 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore nuk financohet nga buxheti i shtetit. Megjithatë, agjencia ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo nga subjekte të tjera. Buxheti i agjencisë miratohet nga ministri i Energjisë dhe Industrisë.”.

“7. Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statutregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”.

2. Në fund të pikës 8 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Drejtori ekzekutiv, për efekt të pagës, klasifikohet në të njëjtin nivel me sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës.”.

3. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

4. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, dhe bashkëlidhur vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 25 shfuqizohet.

II. Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 931, datë 29.12.2014****PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
KULTURËS TË PASURIVE
SHTETËRORE NR. 7/83 DHE NR. 7/82,
NË ZONËN KADASTRALE 8270, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT “QENDRA
KOMBËTARE KULTURORE
“SKENA E RE”“**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 dhe 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronave të paluajtshme shtetërore, me nr. pasurie 7/83, në zonën kadastrale 8270, me përshkrim të veçantë “Instituti i Energjetikës”, me lloj pasurie “truall” dhe “ndërtesë”, me sipërfaqe totale të pasurisë 3 975 (tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) m2, prej të cilave 3 975 (tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) m2 truall dhe 2 216 (dy mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) m2 ndërtesë, dhe të pronës me nr. pasurie 7/82, në zonën kadastrale 8270, me lloj pasurie “truall”, me sipërfaqe totale 32 (tridhjetë e dy) m2, për realizimin e projektit “Qendra Kombëtare Kulturore “Skena e re”“.

2. Ngarkohen ministri i Kulturës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË**

REGJISTRUES
Andrea Mico

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
 ZONA KADASTRALE **8270**
 NR. I PASURISE **7/83**
 INDEKSI I HARTES **TR-T-10-T-11;U-1**
 ADRESA E PASURISE: Rrethi **Tirane**
 Rr/L: **S. FRASHERI**


B. KUFIZIMET
 V _____
 L _____
 J _____
 P _____

C. PRONARI
 SHITET

D. Data **12/9/2014** **Ora** **10:28:59AM**

X 401012.372
 Y 4576412.063

X 400820.949
 Y 4576253.313



**VENDIM****Nr. 933, datë 29.12.2014****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
ORGANIZATIVE TË QENDRËS
KOMBËTARE TË URGJENCËS
MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore (QKUM) është person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila organizohet sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen nr. 1 dhe organigramës, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese, në një sistem mbarështetëror të unifikuar, si dhe për bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme të vendeve fqinje.

Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) përcaktohen, më hollësisht, në ligjin nr. 147/2014, “Për urgjencën mjekësore”.

3. Pjesë të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) janë “Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore” dhe “Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter”.

4. Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore ka për detyrë bashkërendimin e komunikimit të gjithë sistemit të komandë-kontrollit të urgjencave mjekësore. Shërbimi i ofruar nga Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore mund të ofrohet edhe nga operatorë privatë, sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

5. Marrëdhëniet e punës së personelit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Personeli

i sektorit të administratës përzgjidhet nga drejtori i qendrës. Personelin e sektorit mjekësor, të njësive së transportit mjekësor me helikopter dhe të njësive së koordinimit të urgjencave mjekësore përzgjedh ministri i Shëndetësisë, në bazë të konkurrimit të hapur publik, mbështetur në kërkesat e vendit të punës.

6. Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore (QKUM) drejtohet nga drejtori i qendrës, i cili emërohet dhe lirohet nga ministri i Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë përcakton, me udhëzim, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të QKUM-së.

7. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të QKUM-së janë:

a) Drejtimi dhe bashkërendimi i detyrave të punonjësve, me qëllim përmbushjen me sukses të rolit të QKUM-së;

b) Bashkërendimi dhe kontrolli i veprimtarive të trajnimit, si për personelin mjekësor ashtu edhe për paramedikalët dhe publikun e gjerë, të cilat organizohen nga vetë QKUM-ja, apo edhe nga organizata të tjera, me qëllimin e vetëm përgatitjen e mjaftueshme të tyre për të dhënë, në mënyrë cilësore, ndihmën mjekësore;

c) Menaxhimi i fondeve buxhetore dhe fondeve të tjera të krijuara, sipas legjislacionit në fuqi për funksionimin normal të QKUM-së;

ç) Miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM);

d) Bashkëpunimi i ngushtë me institucione të ndryshme dhe organizata që operojnë në fushën e urgjencës mjekësore, brenda dhe jashtë vendit, në mbështetje të procesit të trajnimit dhe certifikimit të personelit apo publikut, në fushën e urgjencës mjekësore;

dh) Përfaqësimi i QKUM-së në marrëdhënie me të tretët.

8. Pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) organizohet dhe funksionon edhe Këshilli Konsultues, si organ konsultativ i drejtorit të QKUM-së, i përbërë nga specialistë të fushës.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

Faqe | 12705




Lidhja nr. 1

STRUKTURA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE

Drejtoria	1
Drejtori	1
Sekretare	
Spektori i Administratës	1
Shef sektori	1
Specialist IT Programues	1
Specialist jurist	2
Sanitare	1
Shofer	
Spektori i financës	
Shef finance	1
Specialist i financës	2
Spektori mjekësor	
Shef sektori	1
Specialist i trajnimit të vazhdueshëm	2
Specialist për supervizimin e ambulancave	1
Specialist i kontrollit të cilësisë	1
Specialist i parandalimit dhe edukimit të publikut	1
Specialist i akreditimit dhe certifikimit	2
Specialist i kërkimit shkencor, zhvillimit dhe regjistrimit të traumës	3
Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore	
Shef sektori	1
Specialist i edukimit dhe mbikëqyrjes	3
Specialist për marrjen e thirrjeve	14
Specialist të vlerësimit të rastit	7
Njësia e transportit mjekësor me helikopter	
Kryepilot	1
Pilot	5
Teknik helikopteri	3
Teknik elektrik	1
Teknik i përgjithshëm	1
Gjithsej 58 persona	



Skema 1



**VENDIM****Nr. 934, datë 29.12.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 909, DATË 22.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIM I BREGUT TË LIQENIT
TË OHRIT DHE GJELBËRIMI
PËRGJATË RRUGËS LIN - POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 909, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall nën objekt dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme prej 439 012 077 (katërqind e tridhjetë e nëntë milionë e dymbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme shpronësimit sipas pikës 3, të këtij vendimi, si dhe shpenzimet procedurale, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2014, si më poshtë vijon:

a) 249 012 077 (dyqind e dyzet e nëntë milionë e dymbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e shtatë) lekë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

b) 190 050 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë e pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2. Pas pikës 6 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Likuidimi i subjektit të shpronësuar dhe përcaktimi i vlerës së likuidimit bëhen

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TABELA E PROJEKTIT “REHABILITIM I BREGUT TË LIQENIT TË OHRIT DHE GJELBËRIMI PËRGJATE RRUGËS LIN-POGRADEC”

NR	OBJEKTI	PRONARI	ADRESA	ZONA KADASTRALE	NR. PASURISE	SIP TRUALL TOTALE SIPAS ZRPP	SIP TRUALL ZENE ME NDERTESE SIPAS ZRPP	VLERA SIPAS VLERESIMIT TË TRUALLIT TË ZENE ME OBJEKT NGA ZRPP	SIP TRUALL ZENE ME NDERTESE SIPAS FAKTIT	VLERA SIPAS VLERESIMIT TË TRUALLIT TË ZENE ME OBJEKT NGA MATJET FAKTIKE	SIPERFAQA TOTALE NDERTIMORE OBJEKTIT SIPAS FAKTIT	VLERA SIPAS VLERESIMIT OBJEKTIT NGA MATJET FAKTIKE	VLERA për LEKE /M2 SIPAS OBJEKTIT FAKTIT	SIPERFAQA TOTALE NDERTIMORE OBJEKTIT SIPAS ZRPP	VLERA SIPAS VLERESIMIT TË OBJEKTIT NGA SIPERFAQET E ZRPP	VLERA TOTALE SHIPRONESIMIT
1	BAR RESTORANT 1 KAT	BASHKEPRONESI FAMILJA SELKO	PISKUPAT, KOMUNA UDENISHT, BREG LIQENI	2973	548/3	339	162	165,640	101	165,640	128	3,200,083	25,079	162	3,200,083	3,365,723
2	BAR RESTORANT LEON, LOKAL SHERBIMI 2 KATE	SHYQYRI ÇELA	PISKUPAT, KOMUNA UDENISHT, BREG LIQENI	2973	562/1	190	190	311,600	216	354,240	432	16,371,109	37,896	380	14,400,513	14,712,113
3	BAR RESTORANT KUKESI 2 KATE DHE NJE NENCATI	AZEM MUHARREM BRAHAJ	POJSKE, KOMUNA UDENISHT, BREG LIQENI	2973	562/5	200	157.3	190,240	116	190,240	348	19,132,173	54,978	472	19,132,173	19,322,413
4	RESTORANT MOTEL NJE KAT NENTOKE DHE DY KATE MBI TOKE	RUZHDI SELKO	POJSKE, KOMUNA UDENISHT, BREG LIQENI	2973	568/11	240	122	200,080	165	270,600	362	20,572,817	54,324	343	18,633,287	18,833,367
5	AMBJENTE SHERBIMI ZYRA DY KAT	AREFI JAKUPLLARI	PISKUPAT, KOMUNA UDENISHT, BREG LIQENI	0	0	0	0	-	210	344,400	442	15,258,006	34,520	413	14,250,011	14,250,011
6	BAR MOTEL 2 KATE	ASTRIT SHAHO	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	2973	571/4	1039	102	167,280	102	167,280	206.6	9,774,478	47,311	204	9,651,469	9,818,749
7	HOTEL BAR RESTORANT “SHEN NAUMI”	NAUM PANO	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	3665	757	290	290	475,600	218	357,520	1,072	57,695,995	39,909	900	47,491,710	47,967,310
									167	273,880	373.7			290		-
8	NDERTESE BANIMI 2 KAT + NENCATI	SHKELQIM REIZ ALLA, MERUSHE ALLA	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	3665	15\1	72	72	118,080	72	118,080	174.8	8,740,000	50,000	144	7,200,000	7,318,080
9	OBJEKT SHERBIMESH 1 KAT PLUS PAPAFIGO TE SHFRYTEZUE SHME	SUFERIN DOKOLLARI	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	3665	17/45	124	124	203,360	187	306,680	250	8,803,993	35,213	124	4,366,385	4,569,745
10	BAR RESTORANT MOTEL 3 KAT	ASLLAN DOKOLLARI	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	3665	17\6	500	115	152,520	93	152,520	390	12,122,270	30,918	345	10,666,840	10,819,360
11	BAR RESTORANT MOTEL 4 KATE	RAFET DOKOLLARI	POJSKE, KOMUNA UDENISHT	3665	17\7	1000	140	229,600	174.7	286,508	750.7	24,477,945	32,607	560	18,259,823	18,489,423



12	PLAZHI PRIVAT KAFETERI	PANAJOT KRISTULI	POJSKE , KOMUNA UDENISHT	3665	17/4 7	2000	130	145,960	89	145,960	89	3,635,148	40,844	130	3,635,147	3,781,107
13	LOKAL ZEMRA E MIRE, OBJEKT 2 KATE	MIMOZA ALILAJ ARBEN ALILAJ ERILD ALILAJ	UDENISHT	0	0	0	0	0	67.5	110,700	88	3,182,806	36,375	-	-	-
14	HOTEL RESTORANT , OBJEKT 4 KAT PLUS KAT NENTOKE + PAPAFINGO	LORENC GOCA	UDENISHT	3665	185/ 7	1335	330	541,200	414	678,960	1,840	49,475,237	26,889	933	25,087,172	25,628,372
									415	680,600	415	4,837,256	11,656	-	-	-
15	LOKAL SHERBIMI HOTEL 3 KATE	MINEVER HAMZALLARI	KOMUNA UDENISHT	3665	185/ 5	288	288	423,120.0	258	423,120	766.0	35,958,894	46,944	766	35,958,894	36,382,014
16	OBJEKT 1-2 KATE, KOMPLEKS KAMPING PESHKU	ASTRIT RIZAN DILAVERI	KOMUNA UDENISHT	3665	254/ 50	1050	150	246,000.0	134.5	220,580	168.0	6,274,321	37,347	150	5,602,072	5,848,072
									34.6	56,744	34.6	1,112,336	32,148	-	-	-
17	OBJEKT 6 KATE PLUS NENCATI TE SHFRYTEZUE SHME	ARDIAN LEKA (FISKU&CONSTRUCITION)	KOMUNA UDENISHT	3665	366/ 5	3000	808	1,189,000.0	725	1,189,000					189,576,911	190,765,911
18	PARKIM DHE RRETHIM	NEIM BREGU	KOMUNA UDENISHT	3665	17/3 6	350	350	574,000.0	350	574,000	350.0	4,642,329	13,264	-	-	574,000
19	LOKAL ZEMRA E MIRE, OBJEKT 2 KATE	LOKAL ZEMRA E MIRE, OBJEKT 2 KATE	UDENISHT	3665	185/ 4	1100	-	-	67.5	-	88	3,182,806	36,375	88	3,182,806	3,182,806
20	BAR KAFE PLAZHI 2 KATE	BAR KAFE PLAZHI 2 KATE	KOMUNA UDENISHT	3665		0	-	-	56.3	-	84.8	3,383,502	39,900	84.8	3,383,502	3,383,502

SHUMA E TRUALLIT
NEN OBJEKT

5,333,280

SHUMA E OBJEKTEVE

433,678,797

439,012,077

**VENDIM****Nr. 936, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. LEFTERI
KODRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Lefteri Kodra, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 937, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. BASHKIM
ZAIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Bashkim Zaimi, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 938, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. LEKA
BUNGO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Leka Bungo, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 939, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. XHEVAHIR
SPAHIU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Xhevahir Spahiu, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM**

Nr. 940, datë 29.12.2014

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. BEJKUSH
BIRÇE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Bejkush Birçe, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 941, datë 29.12.2014

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. DAUT
GUMENI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Daut Gumeni, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 942, datë 29.12.2014

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. HAXHI
RAMA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Haxhi Rama, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 943, datë 29.12.2014

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. EDUARD
AGOSTINI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Eduard Agostini, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 944, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. MEVLAN
SHANAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Mevlan Shanaj, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 945, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ALEKO
MINGA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Aleko Minga, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 946, datë 29.12.2014****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. MEHDI
BUSHATI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Mehdi Bushati, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 947, datë 29.12.2014****PËR AUTORIZIMIN E ALBPETROL SHA
PËR TË MARRË, NË PARA, VLERËN
KORRESPONDUESE TË SASISË SË
PRODHIMIT TË GJYKUAR DHE TË
PJESËS SË ALBPETROL SHA, QË I
TAKON NË BAZË TË ZBATIMIT TË
MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE,
TË LIDHURA ME KONTRAKTORËT,
PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NGA
VENDBURIMET EKZISTUESE TË
NAFTËS E TË GAZIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 9, 12 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë Albpetrol sh.a. që të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol,



sh.a., që i takon në bazë të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit.

2. Për zbatimin e pikës 1, të këtij vendimi, Albpetrol sh.a. duhet të hyjë në negociata me shoqëritë, me të cilat ka lidhur marrëveshje hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe të gazit, në mënyrë që të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., që i takon në bazë të këtyre marrëveshjeve hidrokarbure.

3. Çmimi referues, për të realizuar konvertimin në para të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., do të përllogaritet mbi bazën e çmimit mesatar të ponderuar të naftës bruto, të shitur nga Kontraktori, gjatë muajit kalendarik përkatës, i cili i korrespondon muajit, në të cilin Kontraktori duhet të përmbushë detyrimin ndaj Albpetrol sh.a. për shlyerjen, në para, të Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a. dhe në varësi të vendit të lëvrimit të sasisë së naftës që shitet nga Kontraktori, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet në pikën e lëvrimit në zonën e kontratës, çmimi referues do të jetë i njëjtë me çmimin e shitjes së naftës bruto;

b) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet brenda vendit dhe në një pikë tjetër, të ndryshme nga pika e lëvrimit në zonën e marrëveshjes hidrokarbure, çmimit referues i zbriten kostot e transportit nga pika e lëvrimit te pika respektive shitjes;

c) Në rastin kur sasia e naftës bruto shitet në eksport (shitje FOB), çmimi referues do të llogaritet mbi bazën e çmimit të shitjes, të cilit duhet t'i zbritet kostoja e transportit nga pika e lëvrimit brenda zonës së marrëveshjes hidrokarbure deri në pikën e eksportit (FOB), tarifa e depozitimit, duke përfshirë edhe kostot e mundshme të sigurimit.

Vlerës korresponduese, në para, të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., që Kontraktori i detyrohet Albpetrol sh.a., do t'i zbritet vlera e rentës minerare korresponduese për sasinë përkatëse të naftës bruto, e paguar nga ana e Kontraktorit.

Faqe | 12714

Rregullat e hollësishme dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a. përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 954, datë 29.12.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 374, DATË 11.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 374, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Fondet kundërparti të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave, në shumën 130 517 500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda muajit mars të vitit 2015.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“3. AZHBR-ja mund të realizojë disa herë, brenda muajit mars të vitit 2015, procedurën e pranimi dhe të vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve.”.

c) Në pikën 5, fjalia hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Me këto fonde të financohen investimet për:”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës“Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 644 lekë